



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr ____prot

Tiranë më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 680, datë 20.11.2024

**PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES SONJELA VOSKOPI
PËR PERIUdhËN 2017 - 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares Sonjela Voskopi, për periudhën 2017- 2019”, i hartuar nga relatore znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtares Sonjela Voskopi, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares Sonjela Voskopi në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes, referuar objektit të mosmarrëveshjes dhe natyrës së çështjes (*civile themeli, familjare, kërkesë civile, gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale në fazën e hetimit paraprak*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtarja i kushton rëndësi përshkrimit të detajuar dhe analizës së fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale, kryesisht në vendimet civile të themelit dhe vendimet penale që lidhen me fazën e seancës paraprake ose të themelit, përshkruhen dhe po ashtu analizohen në pjesën e parë të vendimit, në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, përbërjen e trupit gjykues, aspektet procedurale të caktimit të seancës, njoftimit dhe pjesëmarrjes së palëve në seancë, sipas parashikimeve të K.Pr.Penale, si dhe të drejtave procedurale të tyre, për të vijuar me pas, sipas rastit, me ecurinë procedurale të çështjes lidhur me paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, etj.

Në këto vendime gjyqësore ku rrethana procedurale që lidhen me shqyrtimin e kërkesave të palëve apo çështjeve të ngritura kryesisht për vlerësim nga gjykata, përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqërohet me vlerësimin dhe analizën ligjore lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, duke i dhënë qartësi vendimit dhe duke orientuar lidhur me elementë të tillë si: ndërgjyqësia, procedura e gjykimit (*gjykim i shkurtuar në çështjet penale apo riti i shqyrtimit në seancë paraprake*), cilësimin juridik të veprës penale¹, duke ndryshuar cilësimin e saj, zhvillimin e gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, njoftimin, pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e tyre

¹ Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

në gjykim, legjitimitetin aktiv të palës paditëse në raport me shkakun ligjor dhe objektin e padisë/kundërpadisë, etj.

Menjëherë pas paraqitjes dhe vlerësimit në lidhje me rrethanat me karakter procedural, gjyqtarja parashtron faktet e çështjes objekt gjykimi, duke i pasqyruar ato në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit si në çështjet penale, ashtu edhe në çështjet civile, duke i parashtruar ato në mënyrë të qartë, në një rend logjik dhe kronologjik, dhe duke integruar në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën. Faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë koncize dhe të plotë, duke u shoqëruar me evidentimin, referimin dhe analizën e provave të administruara në gjykim, për të mbështetur konkluzionet lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet civile burim vlerësimi, gjyqtarja identifikon dhe përcakton qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, menjëherë pas paraqitjes së rrethanave procedurale dhe analizës së faktit. Në çështjet penale, natyra e çështjes rezulton e qartë nga objekti i çështjes dhe identifikohet në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit, referuar specifikave të çështjeve konkrete, siç janë rastet e çështjeve të seancës paraprake, në të cilat objekti i shqyrtimit rezulton të përcaktohet që në pjesën hyrëse të arsyetimit, duke orientuar edhe natyrën e procedimit të zhvilluar, si dhe faktet që do të jenë objekt vlerësimi në vijim të arsyetimit. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, duke u bërë në mënyrë të shprehur, e në disa raste, si pasojë e një analize ligjore të shkakut dhe objektit të padisë apo të kundërpadisë², posaçërisht në çështjet civile (dhe penale themeli), pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, duke cituar dhe analizuar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale, në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes³. Po ashtu në çështjet penale, identifikimi i natyrës së çështjes objekt shqyrtimi i shërben orientimit të arsyetimit të vendimit, duke reflektuar specifikat e çështjeve penale të themelit dhe atyre të seancës paraprake, në funksion të organizimit të analizës ligjore të çështjes.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi gjyqtarja ka identifikuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural si dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

Sa i përket ligjit procedural:

Në çështjet civile, gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 36/1, 59/1, 41, 42/1, 45/1, 53 dhe 54 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me juridiksionin, dhe kompetencën e gjykatës⁴;

² Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

³ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017; Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁴ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017; Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

- nenin 32/b të Kodit të Procedurës Civile dhe 134 të Kodit të Familjes në lidhje me legjitimitimin aktiv dhe pasiv të palëve ndërgjyqëse; nenin 281 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me pohimet e palëve si provë në gjykim⁵;
- nenin 160 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me shqyrtimin e kundërpadisë dhe nenin 55 të tij në lidhje me bashkimin e kundërpadisë me padinë, si dhe shqyrtimin e tyre në një çështje të vetme⁶;
- neni 106 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me shpenzimet gjyqësore⁷;
- nenet 12, 213, 183/2 dhe 511 paragrafi 4, në lidhje me marrjen në shqyrtim të provave⁸;
- nenet 510 dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit⁹;
- nenin 201 të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi dhe pushimin e çështjes¹⁰;
- nenin 299, gërma “b” të këtij Kodi lidhur me rastet e pushimit të çështjes¹¹.

Në çështjet penale, referuar natyrës së çështjes (*çështje penale e fazës së hetimit paraprak, seancës paraprake apo gjykim themeli*), apo ritit të gjyqimit (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 69, 74 dhe 76/1 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës¹²;
- nenin 58, në lidhje me të drejtat e viktimës së veprës penale¹³;
- nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me të drejtat e viktimës së veprës penale¹⁴;
- nenet 5 dhe 34/4 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur në lidhje me të drejtat e viktimës së mitur¹⁵;
- nenet 151/2 dhe 357/1 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me marrjen e provave në gjykim¹⁶;
- nenin 151 paragrafi 2 dhe 3 i Kodit të Procedurës Penale në lidhje me fuqinë provuese të indicieve dhe deklaratimet e të bashkëpandehurit në një proces penal¹⁷;
- neni 179 në lidhje me caktimin e ekspertit gjatë hetimeve¹⁸;

⁵ Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁶ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁷ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁸ Vendimi nr. 272, datë 23.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁹ Vendimi nr. 272, datë 23.07.2019; Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2019 të i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁰ Vendimi nr. 202, datë 20.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹¹ Vendimi nr. 202, datë 20.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹² Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017; Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 72, datë 06.12.2018; Vendimi nr. 287, datë 31.05.2017; Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018; Vendimi nr. 183, datë 16.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹³ Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019; Vendimi nr.145, datë 27.03.2019; Vendimi nr. 526, datë 11.10.2017; Vendimi nr. 654, datë 10.10.2018; Vendimi nr. 183, datë 16.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁴ Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁵ Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁶ Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017; Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 72, datë 06.12.2018; Vendimi nr. 183, datë 16.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁷ Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

- nenet 290 dhe 291 i Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me rastet kur procedimi penal nuk mund të fillojë dhe shqyrtimin e ankimit për vendimin e mosfillimit të procedimit penal¹⁹;
- nenin 328 paragrafi i parë, në lidhje me rastet e pushimit të akuzës ose të çështjes dhe nenet 329/b dhe 329 paragrafi i tretë, në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës pas shqyrtimit të kërkesës për pushim të paraqitur nga prokurori²⁰;
- nenet 329/3 dhe 329/6 në lidhje me të drejtën e ankimit²¹;
- nenet 332 paragrafi i tretë dhe 332/c paragrafi i pestë, për sa i përket të drejtave të të pandehurit gjatë seancës paraprake; neni 332/dh, në lidhje me disponimin e gjyqtarit të seancës paraprake²² dhe nenet 332/a në lidhje me njoftimin e seancës paraprake 332/b paragrafi i parë në lidhje me zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura; neni 331 paragrafi 2, në lidhje vlefshmërinë e kërkesës për gjykim; nenin 332/ç dhe 332/d në lidhje me plotësinë e hetimeve dhe kthimin e akteve prokurorit; nenin 76/1 në lidhje me kompetencën e gjykatës; neni 332/ë paragrafi i 3, në lidhje përmbajtjen e fashikullit të gjykimit²³ ;
- neni 361 në lidhje me pyetjen si dëshmitar²⁴;
- nenin 363 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me pyetjen e ekspertit në gjykim²⁵;
- nenin 370/3 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me leximin e deklarimeve të bashkëpandehurit në një procedim të lidhur²⁶;
- nenin 375 në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale²⁷;
- nenet 379-386 dhe 390 për shpalljen e vendimit²⁸;
- nenin 400/3 dhe 402/4 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me gjykimin e drejtpërdrejtë të çështjes; nenet 402/3, 402/5, 405/6 të këtij Kodi, në lidhje me kërkesën për t'u gjykuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe nenin 404 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me vendimin për gjykimin e shkurtuar²⁹;
- nenet 406/3, 407/4 në lidhje me të drejtën e ankimit³⁰;
- nenet 406/b paragrafi i parë dhe 406/c i Kodit të Procedurës Penale në lidhje me përmbajtjen e vendimit për miratimin e urdhrit penal dhe rrethanat e refuzimit të urdhrit penal³¹;

¹⁸ Vendimi nr.145, datë 27.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁹ Vendimi nr. 267, datë 19.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

²⁰ Në të gjitha vendimet me objekt pushimin e procedimit penal apo të pushimit të akuzës në çështjet me objekt dërgim në gjyq.

²¹ Vendimi nr.145, datë 27.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

²² Në vendimet me objekt dërgim në gjyq

²³ Vendimi nr. 654, datë 10.10.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

²⁴ Vendimi nr.145, datë 27.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

²⁵ Vendimi nr. 183, datë 16.04.2019; Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

²⁶ Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

²⁷ Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017; Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018; Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

²⁸ Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

²⁹ Vendimi nr. 287, datë 31.05.2017; Vendimi nr. 526, datë 11.10.2017; Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

³⁰ Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 526, datë 11.10.2017; Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

- nenin 393/1 në lidhje me shpenzimet procedurale³² ;
- nenin 393/2 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me shpenzimet e fazës së hetimit paraprak dhe ato gjyqësore³³.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe/ose citon dispozitat materiale të cilat gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori:(i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, konstatohet se:

Në vendimet civile, gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil dhe Kodit të Familjes, ashtu edhe ligjeve të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, lidhur me:

- *Kthim i vlerës së investimeve të sendit dhe Shpërblim për përdorimin e sendit* ku gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 267, 271, 275, 267, 277, 278, 280, 281, 290, 1163, 169, 805, 809, 816 dhe 817 të Kodit Civil në lidhje me parashikimet ligjore që rregullojnë kontratën e qirasë ; nenet 114, 115, 117 dhe 125 në lidhje me parashkrimin e padisë; nenin 296, në lidhje me lirimin dhe dorëzimin e sendit, neni 297 dhe 298 në lidhje me poseduesin me mirëbesim dhe keqbesim si dhe nenet 1165 e 1166 në lidhje me dispozitat tranzitore, që rregullojnë ligjin e zbatueshëm me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Civil³⁴;
- *Zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj*, gjyqtarja identifikon dhe citon nenin 132 të Kodit të Familjes në lidhje me zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort si dhe nenin 146 të Kodit të Familjes në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës përsa i përket mbiemrit të bashkëshortit³⁵.

Krahas dispozitave të Kodit Civil dhe Kodit të Familjes gjyqtarja referon në ligje të posaçme të cilat gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes dhe në një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, duke identifikuar konkretisht:

- nenin 31 të ligjit nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” bashkë me nenin 143 të Kodit të Familjes lidhur me regjistrimin në Zyrën e Gjendjes Civile të vendimit për zgjidhjen e martesës pas marrjes formë të prerë të tij³⁶;
- dispozitat ligjore të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve”, konkretisht nenin 14 i cili rregullon marrëdhënien mes qiramarrësve dhe ish-pronarëve; nenin 19 të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në lidhje me tarifatat e qirasë; nenet 2, 6, 10 dhe 11 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”; VKM nr. 250, datë 16.04.1960 “Për procedurat dhe prioritetet në zbatim të ligjit

³¹ Vendimi nr. 516, datë 05.10.2017; Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

³² Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017; Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 287, datë 31.05.2017; Vendimi nr. 526, datë 11.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

³³ Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

³⁴ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

³⁵ Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

³⁶ Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

nr.8030, datë 15.11.1995”; ligj nr.8647, datë 24.07.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, konkretisht nenin 4 të tij, në lidhje me tarifat e qirasë; nenin 9 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”; akti normaiv me fuqinë e ligjit nr.3, datë 01.08.2012, konfirmuar me ligjin nr.82/2012, neni 1 i tij në lidhje me lirimin dhe dorëzimin e banesave të ish-pronarëve³⁷;

- vendim nr. 5, datë 15.03.1996, të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuzqizuar nenin 11 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”; vendim nr. 26, datë 02.11.2005, të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuzqizuar nenin 9 të ligjit nr. nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”³⁸.

Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal në funksion të analizës së instituteve dhe parimeve të zbatueshme, si më poshtë:

- identifikon në funksion të vlerësimit lidhur me cilësimin juridik të faktit penal objekt akuze: nenin 99 i Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “*Shkaktimi i vetëvrasjes*”³⁹; nenin 283/2 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”⁴⁰; nenin 140 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “*Vjedhja me armë*”⁴¹; nenin 134/1 të Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “*Vjedhja*”⁴²; nenin 277 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “*Vetëgjyqësia*”⁴³; nenin 200 të Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “*Pushtimi i tokës*”⁴⁴; neni 199/a i Kodit Penal për veprën penale “*Ndërtim i paligjshëm*”⁴⁵; neni 290 i Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “*Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor*”⁴⁶; neni 309 i Kodit Penal, në lidhje me veprën penale për të cilën është regjistruar procedimi penal, vepra penale “*Ekspertim i rremë*”⁴⁷; neni 124/b/2 i Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “*Keqtrajtimi i të miturit*”⁴⁸; nenin 89 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “*Plagosja e lehtë me dashje*”⁴⁹; neni 270 i Kodit Penal për veprën penale “*Rebelimi i të burgosurve*”⁵⁰; nenin

³⁷ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

³⁸ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

³⁹ Vendimi nr. 267, datë 19.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁴⁰ Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁴¹ Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁴² Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017; Vendimi nr. 1/140, datë 08.01.2018; Vendimi nr. 287, datë 31.05.2017; Vendimi nr. 526, datë 11.10.2017; Vendimi nr. 844, datë 04.12.2018; Vendimi nr. 105/1029, datë 21.01.2019; Vendimi nr. 30/945, datë 07.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁴³ Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁴⁴ Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁴⁵ Vendimi nr.212, datë 12.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁴⁶ Vendimi nr.145, datë 27.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁴⁷ Vendimi nr. 384, datë 14.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁴⁸ Vendimi nr. 294, datë 15.05.2019; Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁴⁹ Vendimi nr. 516, datë 05.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁵⁰ Vendimi nr. 179, datë 15.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

130/a paragrafi 1, 4 i Kodit Penal në lidhje me veprën penale “*Dhuna në familje*”⁵¹; nenet 141/a, 191/1 dhe 174 të Kodit Penal për veprat penale për të cilat është regjistruar procedimi penal, përkatësisht vepra penale “*Trafikimi i mjeteve motorrike*”, “*Falsifikimi i akteve të gjendjes civile*” dhe “*Kontrabanda me mallra të tjera*”⁵²; nenin 186 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “*Falsifikimi i dokumentave*”⁵³; nenet 121/a/2 dhe 321/2 të Kodit Penal, në lidhje me veprat penale për të cilat akuzohet i pandehuri, përkatësisht veprat penale “*Përndjekja*” dhe “*Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës*”⁵⁴,

- neni 66 i Kodit Penal në lidhje me parashkrimin e ndjekes penale⁵⁵;
- nenin 64 të Kodit Penal, në lidhje me kushtet që duhet të plotësojë i dënuari për t’u liruar me kusht⁵⁶;
- nenin 59 i Kodit Penal në lidhje me papranueshmërinë e kërkesës së mbrojtjes për pezullimin e vendimit me burgim dhe vënien në provë⁵⁷;
- nenin 1/c paragrafi i dytë i Kodit Penal në lidhje me mozbatimin e ligjit penal me analogji⁵⁸;
- nenin 55 të Kodit Penal, në lidhje me caktimin e dënimit për kryerjen e disa veprave penale⁵⁹;
- nenin 3 të Kodit Penal në lidhje me ligjin penal favorizues;
- nenin 22 të Kodit Penal për veprën penale të mbetur në tentativë⁶⁰.

Krahas dispozitave të Kodit Penal dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës si dhe një sërë ligjesh të posaçme në drejtim të vlerësimit të anës objektive të veprave penale specifike, dhe konkretisht:

- nenin 31/6 të ligjit nr.10024, datë 27.11.2008 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale*”, në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës⁶¹
- nenet 3, 41 dhe 52 të ligjit nr.107, datë 31.07.2014, “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, i ndryshuar si dhe nenet 7, 8 të VKM nr.408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”⁶²;
- *vendimin unifikues nr. 2, datë 25.05.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili ka analizuar institutin e lirimit me kusht*⁶³;

⁵¹ Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018; Vendimi nr. 654, datë 10.10.2018; Vendimi nr. 183, datë 16.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁵² Vendimi nr. 486, datë 05.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁵³ Vendimi nr. 486, datë 05.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁵⁴ Vendimi nr. 654, datë 10.10.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁵⁵ Vendimi nr. 1/140, datë 08.01.2018; Vendimi nr. 844, datë 04.12.2018; Vendimi nr. 486, datë 05.07.2018; Vendimi nr. 105/1029, datë 21.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁵⁶ Vendimi nr. 72, datë 06.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁵⁷ Vendimi nr. 183, datë 16.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁵⁸ Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁵⁹ Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁶⁰ Vendimi nr. 30/945, datë 07.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁶¹ Vendimi nr. 72, datë 06.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁶² Vendimi nr.212, datë 12.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁶³ Vendimi nr. 72, datë 06.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

- vendimin unifikues nr.2, datë 29.01.2003 të Gjykatës së Lartë lidhur me gjykimin e shkurtuar⁶⁴;

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë duke u shprehur se: *“Gjatë periudhës objekt vlerësimi kam gjykuar kërkesa të përgjithshme dhe çështje familjare (gjatë vitit 2017), çështje penale (gjatë vitit 2017 dhe 2018) dhe të gjitha natyrat e çështjeve në kompetencë të një gjykate të rrethit gjyqësor, gjatë vitit 2019 për shkak të shkrirjes së dhomave dhe seksioneve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Natyrisht që shqyrtimi gjyqësor i plotë dhe i gjithanshëm i kryer për çështjet, ka patur si qellim parësor përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të çështjes, siç i rezulton gjykatës nga provat e marra në gjykim, pa u ndalur vetëm në përcaktimin që palët i kanë bërë çështjes, madje dhe në çështjet penale, që kanë natyrë më specifike për shkak të pjesëmarrjes së organit të Prokurorisë si përfaqësues i akuzës, analiza e bërë mbi faktin nga ana ime si gjyqtare ka qënë më e gjerë se ajo e parashtruar nga ana e prokurorisë.*

Edhe gjatë arsytimit të një vendimi gjyqësor faktet objekt gjykimi pasqyrohen qartë dhe saktë, me një gjuhë ligjore, por dhe të kuptueshme së pari për palët në proces dhe në vijim për çdo person që do të lexojë vendimin gjyqësor.

Përcaktimi i saktë i fakteve dhe rrethanave të çështjes është thelbësor për të identifikuar natyrën e mosmarrëveshjes ose konfliktit, edhe në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore ose tokësore për gjykimin e saj, me qëllim që vendimmarrja e marrë të mos rezultojë nul nga një gjykatë më e lartë si një vendim i dhënë nga një Gjykatë jo kompetente.

Nëse faktet përcaktohen në mënyre të saktë është shumë e lehtë identifikimi i ligjit të zbatueshëm dhe aplikimit të tij mbi faktet në gjykim.

Në identifikimin e ligjit të zbatueshëm, pas hyrjes në fuqi gjatë vitit 2017 të ndryshimeve në Kodin e Proçedures Civile dhe Kodin e Proçedures Penale, ka patur një kujdes të shtuar mbi normën që do të aplikohet, për çështje të regjistruara para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të tyre, sidomos në situatat kur dispozitat kalimtare nuk e rregullonin problematiken në mënyre të drejtpërdrejte, por kishte vend për interpretim, psh nëse çështja ishte regjistruar para hyrjes në fuqi të ligjit nr.35/2017, a kishte gjykata të drejtë të pranonte kërkesën për gjykim të shkurtuar, në kushtet kur me këto ndryshime, kjo lloj kërkesë mund të parashtrohet vetëm në seancë paraprake, kur kjo lloj seance nuk parashikohej nga ligji në momentin e paraqitjes të çështjes për gjykim në Gjykatë? Pra, do të aplikohet ligji procedural në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për gjykimin e çështjes/akuzës, apo ligji procedural në fuqi në kohën e gjykimit të saj?

⁶⁴ Vendimi nr. 287, datë 31.05.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

Këtij lloji diskutimi i është dhënë zgjidhje prej meje si gjyqtare edhe për problematika që lidhen me ligjin material civil apo penal (në identifikimin e ligjit më të favorshëm për te pandehurin midis ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së veprës dhe kohën e gjykimit).

Në çështje civile kam patur veçanërisht në vëmendje zbatimin e nenit 16 të K.Pr.Civile, e për rrjedhim në përmbajtje të çdo vendimi kam kryer cilesimin e saktë ligjor të fakteve dhe veprimeve të lidhura me çështjen konkrete, pa u lidhur me propozimet e palëve, por në rast duke respektuar kufizimin ligjor: pa ndryshuar kryesisht bazën juridike të padisë. Në përmbajtje të çdo vendimi janë pasqyruar rrethanat e çështjes. Më pas është vijuar me përcaktimin e dispozitave ligjore konkrete që gjejnë zbatim në çështjen objekt gjykimi si dhe zbatimin e tyre konkret në raport me rrethanat e çështjes të provuara në gjykim. Në përfundim të analizës ligjore është parashtruar konkluzioni i gjykatës në lidhje me pranimin ose jo të padisë”

KONKLUZIONI

Në tërësi, spikat aftësia e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizën e fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të detajuar ose të përmbledhur, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e saj.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.*

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore referohen ose citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me

natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Tipar karakteristik i gjyqtarës është se citimi ose referimi i dispozitave, kryesisht atyre që aplikohen drejtpërdrejt për zgjidhjen në themel të çështjes, është shoqëruar me interpretimit të tyre në mënyrë të individuale, para aplikimit mbi faktin konkret. Gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin *teleologjik* të normës konkrete duke identifikuar qëllimin e saj, por edhe interpretimin *literal* dhe *sistematik* të normave, duke përqasur kuptimin e normës me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara.

- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

Në vendimet civile përgjithësisht interpretimi i normës bëhet duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, duke e analizuar më pas normën në përputhje me faktin që ka rezultuar i provuar në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja analizon:

- institutin e kundërpadisë, duke arsyetuar se në rastin objekt gjykimi, gjykata pranoi kërkesën për shqyrtimin e kundërpadisë së bashku me padinë, duke vlerësuar se objekti i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë pasi kërkimet lidhen me të njëjtin send dhe midis tyre mund të bëhet kompesimi, duke vendosur bashkimin dhe shqyrtimin e tyre në një çështje të vetme⁶⁵;
- në mënyrë të përmbledhur dispozitat ligjore⁶⁶:
 - o nenin 14 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish-pronarëve”, i cili rregullon marrëdhënien mes qiramarrësve dhe ish-pronarëve;
 - o nenin 19 të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në lidhje me tarifat e qirasë;
 - o nenet 2, 6, 10 dhe 11 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”,
 - o VKM nr. 250, datë 16.04.1960 “Për procedurat dhe prioritetet në zbatim të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995”; nenin 4 të ligjit nr.8647, datë 24.07.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, në lidhje me tarifat e qirasë;
 - o Nenin 9 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”;
 - o akti normaiv me fuqinë e ligjit nr.3, datë 01.08.2012, konfirmuar me ligjin nr.82/2012, neni 1 i tij në lidhje me lirimin dhe dorëzimin e banesave të ish-pronarëve, duke i aplikuar në rrethanat e rastit konkret;
- nenet 805, 809, 816, 817 të Kodit Civil në lidhje me rregullimet ligjore për kontratën e qirasë⁶⁷;
- nenet 114, 115, 117 dhe 125 të Kodit Civil në lidhje me institutin e parashkrimit të padisë⁶⁸;

⁶⁵ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁶⁶ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁶⁷ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

- institutin e posedimit të sendit dhe analizon detyrimin e poseduesit me mirëbesim dhe keqbesim për shpërblimin e pronarit për përdorimin e sendit⁶⁹;
- të drejtën e paditësit për të kërkuar pushimin e gjykimit, ku konkludon se paditësi ka të drejtë të heqë dorë nga gjykimi i padisë në çdo fazë të gjykimit si shprehje e parimit të disponibilitetit⁷⁰;
- dispozitat procedurale civile në lidhje me titullin ekzekutiv dhe përmbajtjen e urdhrit të ekzekutimit, që gjejnë zbatim në çështjen objekt gjykimi, duke analizuar kushtet që duhet të përmbushen për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit⁷¹;
- nenin 132 të Kodit të Familjes në lidhje me zgjidhjen e martesës me kërkesën e njërit bashkëshort duke marrë në analizë gjithashtu regjimin juridik të zgjidhjes së martesës, institutin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, duke analizuar në rastin konkret lënien e fëmijës për rritje dhe edukim, të drejtën e takimit për prindin tjetër dhe detyrimin për ushqim⁷².

Në vendimet penale gjyqtarja interpreton dispozitat materiale (nenin 99 i Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “*Shkaktimi i vetëvrasjes*”⁷³; nenin 134/1 të Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “*Vjedhja*”⁷⁴; neni 199/a i Kodit Penal për veprën penale “*Ndërtim i paligjshëm*”⁷⁵; neni 290 i Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “*Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor*”⁷⁶; neni 309 i Kodit Penal, në lidhje me veprën penale për të cilën është regjistruar procedimi penal, vepra penale “*Ekspertim i rremë*”⁷⁷; neni 124/b/2 i Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “*Keqtrajtimi i të miturit*”⁷⁸; nenin 89 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “*Plagosja e lehtë me dashje*”⁷⁹; neni 270 i Kodit Penal për veprën penale “*Rebelimi i të burgosurve*”⁸⁰; nenin 130/a paragrafi 1, 4 i Kodit Penal në lidhje me veprën penale “*Dhuna në familje*”⁸¹; nenet 141/a, 191/1 dhe 174 të Kodit Penal për veprat penale për të cilat është regjistruar procedimi penal, përkatësisht vepra penale “*Trafikimi i mjeteve motorrike*”, “*Falsifikimi i akteve të gjendjes civile*” dhe “*Kontrabanda me mallra të tjera*”⁸²; nenin 186 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “*Falsifikimi i dokumentave*”⁸³; nenet 121/a/2 dhe 321/2 të Kodit Penal, në lidhje me veprat penale për të cilat akuzohet i pandehuri,

⁶⁸ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁶⁹ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁷⁰ Vendimi nr. 202, datë 20.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁷¹ Vendimi nr. 272, datë 23.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁷² Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁷³ Vendimi nr. 267, datë 19.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁷⁴ Vendimi nr. 1/140, datë 08.01.2018; Vendimi nr. 844, datë 04.12.2018; Vendimi nr. 105/1029, datë 21.01.2019; Vendimi nr. 30/945, datë 07.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁷⁵ Vendimi nr.212, datë 12.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁷⁶ Vendimi nr.145, datë 27.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁷⁷ Vendimi nr. 384, datë 14.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁷⁸ Vendimi nr. 294, datë 15.05.2019; Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁷⁹ Vendimi nr. 516, datë 05.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁸⁰ Vendimi nr. 179, datë 15.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁸¹ Vendimi nr. 654, datë 10.10.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁸² Vendimi nr. 486, datë 05.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁸³ Vendimi nr. 486, datë 05.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

përkatësisht veprat penale “Përndjekja” dhe “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”⁸⁴), në funksion të cilësimit juridik të veprës penale për të cilën kërkohet dërgimi në gjyq apo pushimi i procedimit penal.

Në gjykimet e themelit, gjyqtarja analizon nenin 283/2 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”⁸⁵; nenin 140 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Vjedhja me armë”⁸⁶; nenin 134/1 të Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “Vjedhja”⁸⁷; nenin 277 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Vetëgjyqësia”⁸⁸; nenin 200 të Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “Pushtimi i tokës”⁸⁹; neni 124/b/2 i Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “Keqtrajtimi i të miturit”⁹⁰; nenin 130/a paragrafi 1, 4 i Kodit Penal në lidhje me veprën penale “Dhuna në familje”⁹¹ në funksion të cilësimit juridik të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri dhe ka nisur gjykimi i tij si dhe të përcaktimit të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj, duke bërë zbrërthimin e normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal dhe duke analizuar elementët e figurës së veprës penale për të cilën procedohet, dhe sipas rastit elementët cilësues të saj. Gjyqtarja interpreton në nivel teorik normën relevante të K.Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, e në vijim, duke e përqsaur me faktet e provuara në gjykim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit.⁹²

Përgjithësisht, dispozitat e Kodit Penal (të pjesës së posaçme) analizohen duke zbrërthyer të katër elementët e figurës së veprës penale.

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin ligjor të veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, në çdo rast gjyqtarja interpreton *dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal*, në drejtim të elementëve dhe instituteve, si më poshtë:

- interpreton dispozitat që lidhen me përcaktimin e *dënimit penal*, duke u ndalur në qëllimin e dënimit penal, individualizimin e tij, kushtet dhe kriteret ligjore që merren në konsideratë në caktimin dhe individualizimin e dënimit (*objekti, vendi, koha, gjendja në të cilën është kryer vepra penale, rrethanat e kryerjes së saj*) dhe rrezikshmërinë e

⁸⁴ Vendimi nr. 654, datë 10.10.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁸⁵ Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁸⁶ Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁸⁷ Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017; Vendimi nr. 287, datë 31.05.2017; Vendimi nr. 526, datë 11.10.2017

⁸⁸ Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁸⁹ Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁹⁰ Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁹¹ Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018; Vendimi nr. 183, datë 16.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁹² Në të gjitha vendimet penale të themelit konstatohet analiza teorike e dispozitave penale në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal, para aplikimit mbi faktet e çështjes.

autorit (gjendja sociale, profesioni, arsimimi, gjendja familjare, gjendja gjyqësore, shkalla e fajit)⁹³;

- analizon institutin e lirimit me kusht, si një nga alternativat e dënimit me burgim dhe në interpretim të nenit 64 të Kodit Penal analizon kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të përfituar i dënuari lirimin me kusht⁹⁴;
- analizon institutin e bashkëpunimit, në drejtim të elementëve të anës objektive dhe subjektive të tij, dhe aplikimin e tij si rrethanë cilësuese apo rënduese⁹⁵;
- analizon rrëzimin e kërkesës së mbrojtësit për aplikimin e institutit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal⁹⁶.

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtarja i jep rëndësi interpretimit të normës së zbatueshme si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh çështjet penale të seancës paraprake. Konkretisht:

- në çështjet penale të themelit gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale në mbështetje të argumentimit të saj në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar (neni 403, 406 i K.Pr.Penale), në mbështetje të të cilit referon edhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë (vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë);
- në vendimet e kategorisë së çështjeve seancë paraprake (dërgim në gjyq), gjyqtarja i kushton rëndësi interpretimit të normave procedurale penale (nenet 329, 329/a, 329/b, 331, 332 e vijues të K.Pr.Penale) në drejtim të përcaktimit të rolit të gjykatës në kontrollin dhe vlerësimin e veprimeve të kryera gjatë fazës së hetimit paraprak; analizës dhe vlerësimit në drejtim të qëllimit të këtij instituti të ri procedural (seancës paraprake); funksionin e kësaj faze procedurale dhe detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake në funksion të vlerësimit të plotësimin të kushteve dhe kritereve ligjore për dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin e procedimit penal; përcaktimin e burimeve të provës dhe formimit të fashikullit të gjykimit; analizën e konceptit të mjaftueshmërisë së provave në mbështetje të provueshmërisë së faktit penal dhe autorësisë; rolin e gjyqtarit të seancës paraprake në lidhje me kryerjen e veprimeve shtesë,⁹⁷ etj.
- në çështjet penale me objekt “pushimin e procedimit penal”, gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale penale në lidhje me rastet e pushimit të akuzës ose të çështjes dhe në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës pas shqyrtimit të kërkesës për pushim të paraqitur nga prokurori (nenin 328 të K.Pr.Penale) dhe në më shumë se një rast dispozitën ligjore që rregullon institutin e parashkrimit të ndjekjes penale (neni 66/ç i K.Pr.Penale)⁹⁸ apo duke analizuar se në rastin objekt gjykimi, lind nevoja për hetime të tjera shtesë duke disponuar me kthimin e akteve prokurorit⁹⁹;

⁹³ Në vendimet penale themeli

⁹⁴ Vendimi nr. 72, datë 06.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁹⁵ Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁹⁶ Vendimi nr. 183, datë 16.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁹⁷ Vendimi nr. 384, datë 14.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁹⁸ Vendimi nr. 844, datë 04.12.2018; Vendimi nr. 105/1029, datë 21.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

⁹⁹ Vendimi nr. 384, datë 14.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

- në çështjen penale me objekt “*Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal*”, në cilësinë e gjyqtarit të hetimeve paraprake, analizon rregullimet ligjore procedurale në lidhje me shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, në lidhje me afatin e shqyrtimit të ankimit, dokumentacionin e depozituar, legjitimitimin e ankuesit, afatin brenda të cilit duhet të paraqitet ankimi. Gjithashtu gjyqtarja analizon se cilat janë veprimet që nuk janë kryer nga prokuroria, përcakton drejtimin e hetimeve dhe veprimet hetimore që duhet të kryhen, duke theksuar se në çdo rast prokuroria mund të kryejë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm¹⁰⁰;
- në çështjen me objekt “*lëshim urdhër ekzekutimi*”, interpreton nenin 510 dhe 511 të K.Pr.Civile në lidhje me titullin ekzekutiv dhe përmbajtjen e urdhrit të ekzekutimit, që gjejnë zbatim në çështjen objekt gjykimi, duke analizuar kushtet që duhet të përmbushen për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit¹⁰¹.

Gjyqtarja trajton dhe zbaton një sërë institutesh:

- Trajton institutin e bashkëpunimit dhe “*ekscesit*” të ekzekutorit në kryerjen e veprës penale duke arsyetuar se në rastin objekt gjykimi ndodhemi para “*ekscesit*” të ekzekutorit¹⁰²;
- Trajton institutin e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, duke arsyetuar se fakti nuk duhet të kualifikohet sipas veprës penale “*Vetëgjyqësia*” por sipas veprës penale “*Pushtimi i tokës*”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal¹⁰³;
- Trajton institutin e dënimit penal dhe atë të individualizimit të dënimit, në lidhje me elementët që duhet të mbahen në konsideratë në caktimin e dënimit¹⁰⁴;
- Trajton institutin e lirit me kusht, si një nga alternativat e dënimit me burgim¹⁰⁵;
- Trajton institutin e interesit të ligjshëm, si dhe legjitimitimin aktiv dhe pasiv të palëve ndërgjyqëse¹⁰⁶;
- Trajton institutin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, duke analizuar në rastin konkret lënien e fëmijës për rritje dhe edukim, të drejtën e takimit për prindin tjetër dhe detyrimin për ushqim¹⁰⁷;
- Zbaton institutin e caktimit të dënimeve për disa vepra penale¹⁰⁸;
- Zbaton institutin e gjykimit të drejtpërdrejtë¹⁰⁹ ;
- Zbaton institutin e parashkrimit të ndjekjes penale¹¹⁰.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës*

¹⁰⁰ Vendimi nr. 267, datë 19.09.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁰¹ Vendimi nr. 272, datë 23.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁰² Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁰³ Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁰⁴ Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 183, datë 16.04.2019; Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁰⁵ Vendimi nr. 72, datë 06.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁰⁶ Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁰⁷ Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁰⁸ Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁰⁹ Vendimi nr. 526, datë 11.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹¹⁰ Vendimi nr. 844, datë 04.12.2018 ; Vendimi nr. 486, datë 05.07.2018; Vendimi nr. 105/1029, datë 21.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil dhe Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë referon:

- vendimin unifikues nr. 2, datë 25.05.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të përfituar i dënuari lirimin me kusht¹¹¹;
- jurisprudencën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, konkretisht vendimin unifikues nr.2, datë 29.01.2003 të Gjykatës së Lartë, lidhur me gjykimin e shkurtuar¹¹²;
- jurisprudencën kushtetuese: vendim nr. 5, datë 15.03.1996, të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuzqizuar nenin 11 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” si dhe vendim nr. 26, datë 02.11.2005, të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar nenin 9 të ligjit nr. nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”¹¹³.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet duke i përmendur ato shprehimisht apo të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtarja njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- Parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit, si të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të humanizmit, përshtatshmërisë së llojit dhe masës së dënimit, të cilat analizohen më pas në raport me rrethanat konkrete të çështjes¹¹⁴;
- Parimin e moszbatimit të ligjit penal me analogji¹¹⁵;
- Parimin e ligjit penal favorizues¹¹⁶;
- Parimin e disponibilitetit, si e drejtë e paditësit të heqë dorë nga gjykimi i padisë në çdo fazë të gjykimit¹¹⁷.

Gjyqtarja e vlerëson aftësinë e saj në këtë tregues në shkallë shumë të lartë duke u shprehur se: “Gjatë punës time kam vlerësuar se thelbësore në zgjidhjen e drejtë të çështjes, përveç identifikimit të sakte të ligjit të zbatueshëm, po aq e rëndësishme është aplikimi i rregullimeve ligjore pikërisht në rrethanat dhe faktet konkrete të çështjes. Në interpretimin e ligjit, në rast se teknika legjislative nuk ka qënë shumë e qartë dhe e saktë dhe e tillë që lë vend për dykuptimshmëri janë përdorur metodat e interpretimit të ligjit si interpretim gramatikor, logjik, sistematik, krahasues dhe teleologjik (pra nisur nga qëllimi që ka patur ligjvënësi me miratimin e normës konkrete). Por, ligji është interpretuar dhe në frymën që përcjellin parimet e së drejtës. Psh, është konstatuar se rregullimet në fuqi të Kodit të Familjes, dhe

¹¹¹ Vendimi nr. 72, datë 06.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹¹² Vendimi nr. 287, datë 31.05.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹¹³ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹¹⁴Në të gjitha vendimet penale themeli edhe pse jo në mënyrë të shprehur

¹¹⁵ Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹¹⁶ Vendimi nr. 486, datë 05.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹¹⁷ Vendimi nr. 202, datë 20.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

disa parashikime te ligjit nr.18/2017” Për Mbrojtjen e fëmijëve”, referuar teknikës legislative të përdorur, ‘duket’ se bien në kundërshtim me njëra tjetrën. Në këto rrethana norma e zbatueshme është interpretuar në funksion të respektimit të parimit baze kushtetues dhe të Konventës Për Mbrojtjen e Drejtave të Fëmijëve, se çdo vendimmarrje duhet të udhëhiqet nga interesi më i lartë i fëmijës.

Gjithashtu, kam qënë e vëmendshme që të konsultohem dhe me praktikën unifikuese dhe njesuese të Gjykatës së Lartë në interpretimin e nje normë ligjore materiale ose procedurale si dhe vendimmarrjet e Gjykatës Kushtetuese.

Në interpretimin e një koncepti juridik ose instituti të së drejtës i jam referuar edhe teorisë së të drejtës.

Në çdo vendimmarrje gjate gjykimit dhe në vendimin përfundimtar për zgjidhjen e çështjes, kam zbatuar parimet përkatëse të procedurës civile dhe penale që lidhen me rolin e gjykatës, pavaresinë dhe paanësinë e saj, barazisë së palëve, parimin e disponibilitetit të padisë si dhe kontradiktoritetit të gjykimit civil, apo parimin e prezumimit të pafajësisë në një gjykim penal, etj. Po kështu kam zbatuar në çdo gjykim edhe parimet përkatëse për barrën e provës në procesin civil dhe penal si dhe detyrimin ligjor të gjykatës për të kryer nje hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, brenda një afati të arsyeshëm.

Gjatë çdo gjykimi, jam kujdesur që të ruhet standarti minimal i mbrojtjes për palët që siguron Konventa e Te drejtave të Njeriut dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së, sidoms në çështje që lidhen me të drejtën e pronës, të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, të drejtën për të qënë i ëur nga arrestimet arbitrare etj. Por, vetëm në raste përjashtimore, jurisprudenca e GJEDNJ-së është pasqyruar në përmbajtje të arsyetimit të vendimit për të mos e bërë këtë të fundit shumë të ngarkuar si tekst dhe abstrakt për palët.”

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet një kujdesi i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.*

1.B ARSYETIMI LIGJOR

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, nuk evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine. Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit apo në kuadër të referimit të ligjeve të posaçme, përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose kuptohet qartë nga konteksti i arsytimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Në arsytimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*përveç ë dhe ç*). Përdor shenjat e pikësimit, thonjëzat dhe simbole të tjera, sipas përkatësisë. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsytimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Të gjitha vendimet janë organizuar në paragrafë me fjali hyrëse të ndarë nga njëri tjetri duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, të cilët lidhen me njëri-tjetrin në mënyrë kronologjike dhe vazhdimësisë së mendimit.

Gjyqtarja e ka vlerësuar treguesin “*qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit*” në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nëndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtarja. Nëse gjyqtarja në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarës në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike, që juristës/ gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtarja në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzionin e arritur.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar nga pikpamja formale, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale apo të themelit të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Këto të fundit vijnë gjithnjë si mbyllje e procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja ndjek përgjithësisht një metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në një paragrafë, të cilat e lehtësojnë shumë të kuptuarit e vendimit duke mundësuar referimin në paragrafët e mësipërm. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit të çështjes, trupi gjykoës dhe sekretarja gjykoësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë/kundërpadiës ose kërkesës në çështjet civile dhe akuza ose objekti i kërkesës në çështjet penale*), baza ligjore si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, të cilat edhe pse nuk janë të identifikuar me tituj, orientojnë lexuesin për përmbajtjen e secilës pjesë të vendimit. Mënyra e organizimit të pjesës përshkuese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimi, edhe pse e paidentifikuar në tituj, ndjek kryesisht këtë renditje:

- (i) *procedura*, duke u ndalur kryesisht në ecurinë procedurale të çështjes si dhe në aspekte që lidhen me të drejtat e palëve, njoftimin dhe pjesëmarrjen e tyre në gjykim, analizën dhe vlerësimin kryesisht të gjykatës lidhur me çështje të juridiksionit, kompetencës, etj. Në këtë pjesë evidentohen edhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. në rastin e shqyrtimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar në çështjet penale të themelit, etj. Në çështjet civile, përveç tre rasteve, nuk rezulton të ketë një pjesë të ndarë të arsyetimit për elementët proceduralë pasi ato janë bërë pjesë e analizës ligjore tërësore, pas pasqyrimin të fakteve të çështjes. Në tre vendimet civile të referuar rezulton që në pjesën hyrëse të jenë analizuar më vete elementët proceduralë lidhur me kompetencën, juridiksionin, përbërjen e gjykatës, thirrjen e personit të tretë në gjykim¹¹⁸, analizën lidhur me mjetin procedural nepërmjet të cilit është investuar gjykata, legjitimitetin e palëve¹¹⁹ apo elementë që lidhen me njoftimin dhe mosparaqitjen e palëve¹²⁰, me pasojë pushimin e gjykimit.
- (ii) *Rrethanat e faktit së bashku me përshkrimin dhe analizën e provave* të lejuara dhe administruara në gjykim, të analizuar në raport me njëra tjetrën, duke konkluduar për faktin e provuar si deduksion i analizës së provave. Faktet e çështjes analizohen në pjesën e dytë ose të parë të vendimit, duke integruar dhe analizuar provat e marra dhe duke u ndalur edhe në vlerën provuese të tyre. Gjyqtarja i kushton rendësi kësaj pjesë të arsyetimit të vendimit, duke u paraqitur faktet e çështjes në mënyrë analitike por edhe koncize, duke i dhënë qartësi faktit penal apo civil objekt gjykimi. Në disa nga vendimet gjykoësore, pas analizës së fakteve të çështjes, evidentohen në një pjesë të veçantë edhe *pretendimet e palëve ndërgjyqëse*¹²¹, ndërsa në rastet e tjera ato janë evidentuar në atë pjesë të arsyetimit të vendimit ku janë marrë në analizë lidhur me bazueshmërinë e tyre.
- (iii) *Ligji i zbatueshëm*. Në shumicën e vendimeve burim vlerësimi, ligji i zbatueshëm, si ai më natyrë procedurale ashtu edhe dispozitat e ligjit material të zbatueshëm, janë pjesë e integruar e analizës ligjore të gjykatës, duke u lokalizuar krahas argumenteve të gjykatës lidhur me elementë të zbatimit të tij.

¹¹⁸ Vendimi nr. 800, datë 25.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjykoësor Korçë

¹¹⁹ Vendimi nr. 805, datë 26.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjykoësor Korçë

¹²⁰ Vendimi nr. 1106, datë 02.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjykoësor Korçë

¹²¹ Vendimi nr. 674, datë 23.07.2018, vendimi nr. 13, datë 18.01.2017, vendimi nr. 1074, datë 25.11.2019, vendimi nr. 226, datë 12.03.2018, vendimi nr. 1153, datë 22.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjykoësor Korçë

(iv) *analizën ose vlerësimin ligjor* të gjykatës lidhur me çështjen. Pas evidentimit dhe analizës së elementëve procedurale, fakteve të çështjes dhe referimit të ligjit të zbatueshëm, arsyetimi vijon me *analizën ligjore të gjykatës*, në të cilin, sipas kategorisë së vendimeve gjyqarja zhvillon analizën ligjore të çështjes. Kjo analizë, referuar kompleksitetit të çështjes është e organizuar në në paragrafë, ku merren në analizë secili nga kërkimet e objektit të padisë, apo analizën lidhur me përgjegjësinë penale për secilin të pandehur apo vepër për të cilën procedohet, në vendimet penale.

Konkretisht, në *vendimet penale të seancës paraprake*, gjyqarja e ka organizuar arsyetimin sipas kategorisë së elementëve që merr në vlerësim, si (i) analizën e rolit dhe funksionit të gjyqarit të seancës paraprake, në të cilën analizohen edhe përmbajtja dhe qëllimi i neneve repsektive të ligjit që normojnë këtë fazë të procedimit dhe llojet e vendimmarrjeve të gjykatës, për tu përmbyllur më një konkluzion të saj mbi analizën respektive të ligjit; (ii) vlefshmërinë e akteve procedurale; (iii) vlerësimin mbi kërkesën për procedim me gjykim të shkurtuar; (iv) përmbajtjen dhe formimin e fashikullit të gjykimit dhe (v) ekzistencën e përgjegjësisë penale dhe cilësimit juridik të faktit penal apo ndryshimit të tij¹²². Në *vendimet penale të themelit* gjyqarja e ka organizuar këtë pjesë të vendimit duke ju analizuar fillimisht elementët e figurës së veprës penale për secilin të pandehur për të vijuar me pas me analizën ligjore në drejtim të caktimit dhe individualizimit të dënimit¹²³.

Në *vendimet civile dhe familjare* burim vlerësimi, gjyqarja e organizon pjesën e analizës ligjore duke marrë në vlerësim, në mënyrë të veçantë secilin kërkim objekt padie, apo secilin elementët që ajo vlerëson të nevojshme për t'iu nënshtruar analizës ligjore si p.sh lidhur me legjitimitetin e palëve, interesin e ligjshëm të tyre, natyrën e mjetit të kërimit me të cilin është investuar gjykata, etj. Pjesë e analizës ligjore, në përmbajtje apo në përfundim të argumentimit të saj lidhur me zgjidhjen e çështjes, janë edhe pretendimet e palëve të cilat merren në analizë me vete një për një duke i dhënë një përgjigje të argumentuar çdo kërkesë¹²⁴. Në tërësi, gjyqarja organizon pjesën e arsyetimit ligjor të vendimit duke ndjekur kryesisht metodën e dhënies së konkluzionit të saj mbi bazueshmërinë ose jo të kërtimeve objekt padie, për të vijuar më pas me shtjellimin dhe renditjen e argumenteve në mbështetje të këtij konkluzioni.

Në *çështjet penale*, analiza ligjore organizohet duke filluar me konkluzionin mbi ekzistencën e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit dhe më tej, me referimin e ligjit material të zbatueshëm, zbërthimin dhe analizën e elementëve të figurës së veprës penale konkrete dhe përjasjen e tyre me faktin penal të provuar në gjykim, për të vijuar, me analizën në një pjesë më vetë, lidhur me përcaktimin e llojit dhe të masës së dënimit.

Në *vendimet e seancës paraprake* me objekt « Dërgimin e çështjes në gjyq », gjyqarja në pjesën e fundit të arsyetimit të vendimit, evidenton përmbajtjen e

¹²² Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017; Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019

¹²³ *Vendimet penale të themelit*

¹²⁴ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017; Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2019

fashikullit të gjyqimit në rastin e pranimit të kërkesës, në kuptim të nenit 332/ë të K.Pr.C.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarës dhe sekretarës gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi : (i) çdo kërkim të objektit të padisë/kundërpadisë apo kërkesës (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), (ii) përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (*deklarimin fajtor*), (iii) ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale¹²⁵ apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike të seancës paraprake (*dërgimin në gjyq apo pushimin e procedimit penal*), (iv) dënimin dhe masën e dënimit, (v) llogaritjen e dënimit, (vi) mënyrën e ekzekutimit të tij, (vii) disponimi mbi provat materiale, (viii) masat e sigurimit si dhe (ix) shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal ose civil, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile, (ii) nenet 332/ç, 332/dh dhe 332/e dhe nenin 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet e seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, (iii) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale themelit, etj.

Siç u theksua më lartë, gjyqtarja ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, kjo sikundër e cituam edhe më sipër, duke i ndarë vendimet në paragrafë, ku gjyqtarja zbaton rregullat e shkrimit ligjor, duke identifikuar faktet, provat, argumentin ligjor në lidhje me faktet, ligjin e zbatueshëm, analizën juridike dhe konkluzionin e arritur.

Megjithatë titujt e nëndarjeve të vendimit gjyqësor (*procedura, rrethanat e çështjes, ligji i zbatueshëm, vlerësimi/arsyetimi i gjykatës*) të cilët gjyqtarja nuk i përdor, nuk janë të vetme mjete të majftueshme për organizimin e argumentit logjik. Janë paragrafët, të cilët gjyqtarja i përdor shumë mirë, ata që e organizojnë shkrimin sipas ideve dhe lehtësojnë të kuptuarit e mendimit, duke e ndarë në njësi më të thjeshta, paragrafë të cilat duhen rënditur në atë mënyrë që mendimi të vijë rrjedhshëm, njëri pas tjetrit.

Gjyqtarja e ka vlerësuar aftësinë e saj për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave në shkallë shumë të lartë. Ai shprehet se: “*Në arsyetimin e një vendimi gjyqësor kam zgjedhur të përdor metodën që njihet në literaturën juridike si metoda IRAC. Pra :*

-pasqyrimi i rrethanave konkrete të çështjes, ashtu siç kanë rezultuar për gjykatën të provuara në gjykim, duke e plotësuar me pretendimet e palëve mbi faktin në gjykim;

-pasqyrimi i normës/normave materiale të zbatueshme;

-aplikimi i normave materiale mbi rrethanat konkrete të çështjes;

¹²⁵ Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017

-konkluzioni mbi zgjidhjen e çështjes dhe arsyet pse një ose disa nga pretendimet e palëve nuk rezultojnë të bazuara.

Gjatë arsyetimit të një vendimi gjyqësor nuk përdor teori. Më duket e pakuptimtë psh që të mbushet me faqe të tëra një vendim duke shpjeguar teorikisht se çfarë është « padia e kthimit të sendit » etj ose si përkufizohet nga literatura juridike « trashëgimia » si institut, apo të përdoren paragrafe të tërë për të shpjeguar rëndësinë që ka gjykimi i një çështje nga gjykata kompetente, kur asnje nga palët nuk ka parashtruar ndonjë pretendim mbi mungesën e kompetencën në çështjen konkrete.

Edhe praktikën gjyqësore e kam pasqyruar në mënyrë sa më të kufizuar dhe konçize, kryesisht vendime unifikuuese ose njësuuese që kanë interpretuar normën konkrete të së drejtës që lidhet më rastin në gjykim, vendime që janë të detyrueshme për zbatim, kjo për të mos e bërë vendimin e gjatë e të tillë që vëmendja normale e një njeriu të humbë dhe të shpërqëndrohet gjatë leximit të tij, pa u kuptuar mosmarrëveshja konkrete dhe zgjidhja që i ka dhënë gjykata asaj.”.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, të ndarë në paragrafë të të cilat janë rënditur në atë mënyrë që mendimi të vijë rrjedhshëm, njëri pas tjetrit. Gjyqtarja ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuar kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të cilat janë pjesë e rrethanave të faktit, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Konstatohet që janë përdorur paragrafë dhe fjali hyrëse tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar përgjithësisht lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtarja, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke

parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohej një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar¹²⁶.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, i detajuar dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjykimit, kryesisht çështje të kompetencës lëndore; përcaktimit të barrës së provës dhe rolin e gjykatës në funksion të vlerësimit të shkakut ligjor të padisë; rolin dhe funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes në këtë fazë të procedimit; procedimit me gjykim të shkurtuar si dhe pjesëmarrjen dhe të drejtat e të dëmtuarit në gjykim, etj.

Arsyetimi i vendimeve burim vlerësimi ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material (civil apo penal), duke bërë një analizë tërësore dhe koncize të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim. Pasi dispozita zbërthehet dhe interpretohet në kuptimin abstrakt, ajo vijon të aplikohet mbi faktet e çështjes konkrete, në shërbim të zgjidhjes së çështjes. Gjyqtarja tregon kujdes në arsyetim dhe mënyrën e organizimit të tij, për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me natyrën e mosmarrëveshjes/çështjes dhe zgjidhjen e saj në themel.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi gjyqtarja kujdeset për të evidentuar në mënyrë të qartë thelbin e konfliktit/çështjes, duke orientuar analizën juridike dhe duke zhvilluar argumentimin logjik të saj, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja i kushton rëndësi evidentimit dhe argumentimit ligjor në drejtim të marrëdhënies shkak-pasojë, në përjasjen e ligjit me faktet konkrete. Arsyetimi i vendimeve është i qartë dhe gjithëpërfshirës, duke i dhënë përgjigje pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse si dhe çështjeve të ngritura kryesisht për diskutim nga gjyqtarja.

Në vendimet civile burim vlerësimi gjyqtarja i kushton rëndësi analizës me të zgjeruar së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, p.sh :

- (i) Institutin e kundërpadisë, duke arsyetuar se në rastin objekt gjykimi, gjykata pranoi kërkesën për shqyrtimin e kundërpadisë së bashku me padinë, duke vlerësuar se objekti i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë pasi kërkimet lidhen me të njëjtin send dhe midis tyre mund të bëhet kompesimi, duke vendosur bashkimin dhe shqyrtimin e tyre në një çështje të vetme¹²⁷;

¹²⁶ Vendimi I GJEDNJ, Cështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

¹²⁷ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

- (ii) *Instituti* e parashkrimit të padisë, rregulluar nga nenet 114, 115, 117 dhe 125 të Kodit Civil, duke konkluduar se padia e paraqitur nga paditësi është parashkruar me kalimin e afatit 10 vjeçar¹²⁸;
- (iii) *instituti* e posedimit dhe analizon detyrimin e poseduesit me mirëbesim dhe keqbesim për shpërblimin e pronarit për përdorimin e sendit. Në raport me ligjin dhe provat e administruara në gjykim, konkludon se kundërpadia duhet të pranohet pjesërisht. Gjithashtu i jep përgjigje pretendimeve të paditësit të kundërpaditur në lidhje me parashkrimin e padisë duke arsyetuar se kundërpadia është brenda afatit të parashkrimit¹²⁹;
- (iv) *instituti* e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, duke analizuar në rastin konkret lënien e fëmijës për rritje dhe edukim, të drejtën e takimit për prindin tjetër dhe detyrimin për ushqim¹³⁰;
- (v) *instituti* e interesit të ligjshëm, si dhe legjitimitimin aktiv dhe pasiv të palëve ndërgjyqëse¹³¹;
- (vi) *Instituti* e detyrimit për ushqim duke arsyetuar se gjykata duhet ta përcaktojë pavarësisht kërtimeve të palëve ndërgjyqëse. Në lidhje me detyrimin për ushqim në rastin konkret ka analizuar se mbahen në konsideratë: mosha dhe nevojat e fëmijës së mitur; stili i jetesës së palëve ndërgjyqëse¹³²;
- (vii) “*Urdhërit të ekzekutimi*” sa i përket kushteve që duhet të plotësohen në mënyrë që të lëshohet kërkesa për lëshimin e tij, në interpretim të neneve 510/1, 511 të Kodit të Procedurës Civile : i) ekzistenca e një titulli ekzekutiv të parashikuar nga ligji; dhe ii) kërkesa të bëhet nga kreditori. Në këtë aspekt gjyqtarja arsyeton se kontrata e kredisë është e vlefshme dhe përbën akt të kredisë bankare nga një institucion financiar jo bankar, i licensuar nga Banka e Shqipërisë; urdhri i ekzekutimit kërkohet nga kreditorit kundrejt debitorit; detyrimi është bërë i kërkueshëm, pala nuk e ka përmbushur detyrimin megjithëse është njohur rregullisht për të¹³³;

Në vendimet penale burim vlerësimi, karakteristikë e gjyqtarës është paraqitja dhe analiza e detajuar e fakteve të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe marrja në analizë e tyre në drejtim të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet, rolin dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit në raport me faktin penal. Çdo fakt i vlerësuar si i provuar lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë provën/provat përkatëse, me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin, si dhe elementin që sjell secila prej tyre në shërbim të provueshmërisë së tij. Gjyqtarja integron në mënyrë të natyrshme faktin e provuar me analizën dhe interpretimin e ligjit të zbatueshëm në rastin konkret, si në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal, ashtu edhe në drejtim të vlerësimit të kushteve ligjore për zgjidhjen e çështjeve me karakter procedural.

¹²⁸ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹²⁹ Vendimi nr. 727, datë 05.06.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹³⁰ Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹³¹ Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹³² Vendimi nr. 1278, datë 06.11.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹³³ Vendimi nr. 272, datë 23.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

Gjyqtarja ndalet në evidentimin e qartë dhe në mënyrë të natyrshme të lidhjes shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurit në raport me faktin penal të provuar në çështjet e themelit, faktin penal objekt akuze në çështje të seancës paraprake, apo në raport me faktin për të cilin kërkohet pushimi i procedimit penal. Në çdo rast interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsytimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimin logjik, në mbështetje të konkluzioneve të saj për zgjidhjen e çështjes, kryesisht në drejtim të :

- (i) analizës së figurës konkrete të veprës penale për të cilën procedohet, zbërthimin dhe analizën e elementëve e saj si dhe autorësisë e të pandehurit¹³⁴;
- (ii) institutin e dënimit penal dhe atë të individualizimit të dënimit, në lidhje me elementët që duhet të mbahen në konsideratë në caktimin e dënimit në rastin konkret të tilla si: rrezikshmëria e veprës penale; përhapjen e veprës; rrezikshmërinë e të pandehurit; qëndrimin pohues dhe pendues të të pandehurit; gjendjen familjare, ekonomike dhe nivelin arsimor të të pandehurit¹³⁵;
- (iii) institutin procedural të gjykimit të shkurtuar, duke analizuar në çdo rast kushtet procedurale për pranimin e tij së bashku me analizën dhe vlerësimin mbi kushtet thelbësore që vlerësohen për procedimin me këtë rit të posaçëm gjykimi¹³⁶;
- (iv) institutin e bashkëpunimit dhe “*ekscetit*” të ekzekutorit në kryerjen e veprës penale duke arsyetuar se në rastin objekt gjykimi ndodhemi para “*ekscetit*” të ekzekutorit¹³⁷ ;
- (v) institutin e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, duke arsyetuar se fakti nuk duhet të kualifikohet sipas veprës penale “*Vetëgjyqësia*” por sipas veprës penale “*Pushtimi i tokës*”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal¹³⁸ ;
- (vi) institutin e dënimit penal dhe atë të individualizimit të dënimit, në lidhje me elementët që duhet të mbahen në konsideratë në caktimin e dënimit¹³⁹ ;
- (vii) institutin e lirimit me kusht, si një nga alternativat e dënimit me burgim dhe në interpretim të nenit 64 të Kodit Penal dhe jurisprudencës unifikuese të Gjykatës së Lartë, analizon kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të përfutur i dënuari lirimin me kusht¹⁴⁰;
- (viii) Zbaton institutin e parashkrimit të ndjekjes penale¹⁴¹ ;
- (ix) Zbaton institutin e gjykimit të drejtpërdrejtë. Në interpretim të dispozitave procedurale që rregullojnë gjykimin e drejtpërdrejtë, ka arsyetuar se plotësohen kushtet për zhvillimin e gjykimit të drejtpërdrejtë, duke argumentuar se: i

¹³⁴ Në të gjitha vendimet penale të themelit apo edhe ato të seancës paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, gjyqtarja ndalet në analizën e elementëve të figurës së veprës penale dhe përjashtjen e faktit të provuar në raport me to, në funksion të vlerësimit të saj mbi cilësimin juridik të faktit penal për të cilin procedohet.

¹³⁵ Në të gjitha vendimet penale themeli të përfunduara me dënimin e të pandehurit

¹³⁶ Vendimi nr. 287, datë 31.05.2017; Vendimi nr. 526, datë 11.10.2017; Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹³⁷ Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹³⁸ Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹³⁹ Vendimi nr. 298, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 183, datë 16.04.2019; Vendimi nr. 409, datë 28.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁴⁰ Vendimi nr. 72, datë 06.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁴¹ Vendimi nr. 844, datë 04.12.2018 ; Vendimi nr. 486, datë 05.07.2018; Vendimi nr. 105/1029, datë 21.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

pandehuri është arrestuar në flagrancë; arresti është vlerësuar i ligjshëm dhe ndaj tij është caktuar masa “arrest me burg”; kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë është paraqitur brenda afatit ligjor 30 ditor¹⁴² ;

- (x) analizën e figurës së gjyqtarit të seancës paraprake, rolin e tij, qëllimin e kësaj fazë të procedimit dhe elementet që janë objekt kontrolli nga gjykata me qëllim përgatitjen e çështjes për gjykim. Në kuadër të kësaj analizë gjyqtarja ndalet dhe analizon dispozitat mbi pavlefshmërinë e akteve dhe papërdorshmërinë e provave, mjaftueshmërinë e provave dhe ligjshmërinë e marrjes së tyre, para aplikimit të tyre mbi faktin konkret dhe vlerësimin përfundimtar mbi çështjen¹⁴³.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi (*me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.*) Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar në përmbajtje të arsyetimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçuar të arsyetimit (*por në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret*), pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsyetimit tërësor.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin "*cilësia e analizës dhe argumentimit logjik*" në shkallë shumë të lartë, duke u shprehur se "*Në arsyetimin e vendimit marrë në analizë të gjitha faktet, provat, kundërshtimet, prapësimet, duke përcaktuar drejtë faktin dhe interpretuar dispozitat ligjore përkatëse që më kanë çuar në zgjidhjen e çështjes. Gjithashtu, u kam dhënë përgjigje kërkesave të palëve të natyrës procedurale dhe materiale, duke arsyetuar në çdo rast vendimet e ndërmjetme.*"

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin "*Cilësia e analizës dhe argumentit logjik*". Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

¹⁴² Vendimi nr. 526, datë 11.10.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁴³ Vendimet e seancës paraprake me objekt "*Dërgimin e çështjes në gjyq*"

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezultojnë se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 1350 çështje për të cilat ligji parashikon afat shqyrtimi (ligjor ose orientues), të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Tregtare me palë kundërshtare”, “Marrëdhënie pune”, “Penale krime”, Penale kundravajtje”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, “Penale seancë parapake” dhe “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit”

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se nga 368 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 50 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 318 çështje janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (50 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (368 çështje), gjyqtarja rezultojnë që të ketë gjykuar **13.5 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.**

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja parashtron, ndër të tjera, “Nga statistikat e vëna në dispozicion:

-Për vitin 2017 afatet ligjore nuk janë respektuar në 18 çështje, nga 339 çështje të gjykuara në total, nga të cilat për 71 çështje janë parashikuar afate ligjore. Këto vonesa kanë ardhur për arsye objektive, të pavarura nga vullneti im si gjyqtare, të tilla si psh në kërkesat me objekt lëshim urdhëri ekzekutimi, që përbëjnë 11 raste e që duhet të shqyrtoheshin brenda afatit 5 ditor, dita e 5 ka rezultuar ditë pushimi zyrtar ose çështja është shortuar ditë të premtë dhe ka mbërritur në zyrën e gjyqtarit ditë të hënë, duke humbur dy ditë në mënyrë jo produktive.

-Shkak tjetër ka qënë sjellja e palëve, që kanë kërkuar shtyrjen e seancave gjyqësore, në disa raste për shkaqe të përligjura të provuara me dokument, por dhe për shkaqe të dyshimta për ekzistencën e tyre, por në përgjithësi kam zgjedhur që midis të drejtës së palës për t’u dëgjuar dhe detyrimit të respektimit të afatit ligjor në shqyrtimin e çështjes të respektoj të drejtën e palës për t’u dëgjuar në gjykim.

-Pavlefshmëria e njoftimit evidentohet si shkak për shtyrjen e ndonjë prej seancave gjyqësore ose pjesëmarrja e mbrojtësve në gjykime të tjera dhe vijimi i seancës në kundërshtim me vullnetin e palës për të mos vazhduar pa avokat, do të përbënte cënim të së drejtës për një mbrojtje efektive, patur parasysh mungesën e njohurive juridike të vetë palës.

- Për vitin 2018 afatet ligjore nuk janë respektuar në 5 çështje, nga 447 çështje të gjykuara në total, nga të cilat për 149 çështje janë parashikuar afate ligjore. Nga 5 çështje në një prej tyre afati është tejkaluar vetëm me një ditë ndërsa në një tjetër me 2 ditë. Në 3 çështjet e tjera afati është tejkaluar për shkak të kërkesave të palëve.

-Për vitin 2019 afatet ligjore nuk janë respektuar në 3 çështje, me vetëm pak ditë, nga 534 çështje të gjykuara në total, nga të cilat për 134 çështje janë parashikuar afate ligjore.

Pra, në 3 vitet objekt vlerësimi për 354 çështje për të cilat janë parashikuar afate ligjore, për arsye objektive (si ditët e pushimeve në fundjavë, kërkesat e palëve dhe mbrojtësve, pavlefshmëria e njoftimeve), dhe pa sjellë asnjë pasojë, afatet ligjore nuk janë respektuar në gjithësej 26 çështje, duke u klasifikuar shkalla e aftësive për menaxhimin e çështjeve si shumë e lartë.”

Në përllogaritjen e afateve ligjore, për të gjitha dosjet, përllogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtarit), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përllogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune për gjyqtarët apo 35 ditë kalendarike);
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve 6 ditë;

Po ashtu, gjyqtarja ka shpjeguar lidhur me kohëzgjatjen e disa çështjeve, të cilat, referuar tabelave me të dhëna statistikore, në raport me shpjegimet e tij dhe qëndrimin e mbajtur deri më tani, rezulton si vijon:

- për vitin 2017 ;

(i) në tabelën nr. 2, çështjet me nr. rendor 13-22 me objekt “*Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit*”¹⁴⁴, janë shortuar (çështjet me nr.rendor 13, 14, 15) me 25.01.2017 dhe përfunduar me 31.01.2017, shortuar më (çështjet me nr.rendor 16, 17, 18) 26.01.2017 dhe përfunduar me 01.02.2017 dhe shortuar (çështjet me nr.rendor 19, 20, 21 22) 27.01.2017 dhe përfunduar me 02.02.2017, pra për 6 dië. Tejkalimi me 1 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështjet do **të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor 5 ditor.**

(ii) në tabelën nr. 12, çështja me nr. rendor 83, me objekt “*Përfundim gjyqtari*”¹⁴⁵, është shortuar me datë 24.11.2017 dhe ka përfunduar me datë 27.11.2017, gjykuar për 3 ditë. Tejkalimi me 1 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështja do **të konsiderohet si e përfunduar brenda afatit ligjor 2 ditor.**

- për vitin 2018 ;

(i) në tabelën nr. 10, çështja me nr. rendor 37 me objekt “*verifikim i nevojave të sigurimit*”¹⁴⁶, është shortuar më datë 31.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 03.08.2018, pra gjykuar për 3 ditë. Tejkalimi prej 24 orë (1 ditë) do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështja do **të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor 2 ditor.**

(ii) tabelën nr. 10, çështja me nr. rendor 41 me objekt “*Ankim kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal*”¹⁴⁷, është shortuar më datë 17.08.2018 dhe ka përfunduar me datë 17.09.2018. Nëse zbresim këtu lejen vjetore të muajit gusht, rezulton se çështja me nr. 41 është gjykuar për 11 ditë. Pra, çështja është **përfunduar brenda afatit ligjor 30 ditor.**

(iii) në nr. 11, çështjet me nr. rendor 6, 8, 88, 132, 133 dhe 135 me objekt “*Dërgim çështje në gjyq*”¹⁴⁸, janë përkatësisht, shortuar më datë 12.12.2017 dhe ka përfunduar më datë 04.01.2018, shortuar më datë 15.12.2017 dhe ka përfunduar me datë 08.01.2018, shortuar më datë 04.05.2018 dhe ka përfunduar me datë 06.06.2018, shortuar me datë 25.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 07.09.2018, shortuar më datë 26.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 11.09.2018 dhe shortuar me datë 31.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 24.09.2018 janë gjykuar për 36 ditë, 31 ditë, 32 ditë, 43 ditë, 46 ditë dhe 54 ditë. Nëse zbresim këtu festat e fundvitit dhe mbartjen e dosjeve si dhe lejen vjetore të muajit gusht, rezulton se çështjet janë përfunduar për 30 ditë, 25 ditë, 32 ditë, 8 ditë, 11 ditë dhe 19 ditë. Tejkalimi me 2 dite për njëren nga çështjet do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështjet do **të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor 30 ditor.**

- për vitin 2019 ;

(i) në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 93 dhe 103 me objekt “*Dërgim çështje në gjyq*”, janë shortuar më datë 11.03.2019 dhe ka përfunduar me datë 12.04.2019 dhe shortuar më datë 24.07.2019 dhe ka përfunduar me datë 06.09.2019 janë gjykuar për 31 ditë dhe 43 ditë. Nëse zbresim këtu lejen vjetore të muajit gusht,

¹⁴⁴ Neni i 510 i Kodit të Procedurës Civile, përpara ndryshimeve me Ligjin nr. 38/2017, hyrë në fuqi në datën 05.11.2017, parashikonte afatin ligjor prej 5 ditësh

¹⁴⁵ Neni 22 të Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar afati ligjor i gjykimit 48 orë.

¹⁴⁶ Neni 248 i K.Pr.Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 5 ditë për masat e tjera të sigurimit.

¹⁴⁷ Neni 291 të Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar afatin ligjor i gjykimit 30 ditë.

¹⁴⁸ Neni 332 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë.

rezulton se çështjet janë gjykuar për 31 ditë dhe 8 ditë. Tejkalimi me 1 dite i njëres çështje do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështjet do të **konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor 30 ditor.**

Për pasojë, duke konsideruar shpjegimet e mësipërme **21 çështjet e mësipërme do të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor.**

Lidhur me çështjet e përfunduara tej afati ligjor për të cilat gjyqtarja ka dhënë shpjegime pa iu referuar konkretisht, gjyqtarja ka parashtruar se përfundimi i tyre tej afatit ka qenë tërësisht për shkaqe objektive që lidhen me ditët e pushimit zyrtar ose çështja është shortuar ditë të premte dhe ka mbërritur në zyrën e gjyqtarit ditë të hënë, sjelljen e palëve, që kanë kërkuar shtyrjen e seancave gjyqësore, në disa raste për shkaqe të përligjura apo në lidhje me pavlefshmërinë e njoftimit ose pjesëmarrjen e mbrojtësve në gjykime të tjera etj.

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore si dhe çështjeve të analizuara më sipër, rezultoi se numri i çështjeve me afat ligjor është 368 çështje. Po ashtu në numrin e çështjeve me afat ligjor, të përfunduara tej këtij afati (50 çështje), duhet të zbriten 21 çështje, pasi referuar analizës për secilën prej tyre, rezultoi se ato duhet të konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor. Në këtë mënyrë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (29 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (368 çështje), rezulton të jetë 7.8 %, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 15 pikë.

Gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë kriter në shkallë shumë të lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (*deri në 2 ditë*), atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 29 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (29 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (368 çështje), rezulton të jetë **7.8 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor**, përqindje që sipas Metodologjisë vlerësohet me me 15 pikë. Gjithashtu, rezultoi se gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtarja ka përmballuar një ngarkesë jo të vogël, duke gjykuar 1350 çështje në 3 vjet apo pra rreth 450 çështje në vit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Respektimi i afateve ligjore” është “shumë i lartë”, brenda marzhit “0-10 %”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 982 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (260 çështje në vitin 2017, 323 çështje në vitin 2018 dhe 399 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Marrëdhënie pune”, “Penale krime”, “Penale kundërvajtje” dhe “Seanca paraprake-kërkesa për pushimin e procedimit penal” për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj (180 ditë) për gjykimet civile të themelit;
- jo më tej se 4 muaj (120 ditë) për gjykimet familjare;
- jo më tej se 9 muaj (270 ditë) për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj (365 ditë) për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 4 muaj (120 ditë) për kundërvajtjet penale;
- jo më tej se 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 982 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 72 prej tyre ose **14.7 % janë gjykuar tej standardit minimal kohor në fuqi.**

Në formularin e integruar të vlerësimit, referuar këtij treguesi, gjyqtarja shprehet “...Pra, për 3 vite, nga 966 çështje të marrë në analizë, standardi kohor minimal i caktuar për gjykimin e tyre është tejkaluar në 29 çështje që është më pak se 10%, pra shkalla e aftësisë rezulton shumë e lartë. Disa nga shkaqet e tejkallimit të afateve orientuese të gjykimit për 3 vitet objekt vlerësimi rënditen si më poshtë:

-Disa nga çështjet vendimet për të cilat janë shpallur në tejkallim të afateve kanë qenë më objekt pjesëtim pasurie, ku gjykimi është shoqëruar me ekspertim dhe pyetje shtese për ekspertët, si dhe vendimet e fazës së parë të pjesëtimit janë ankimuar në Gjykatën e Apelit Korçë, duke passjellë pezullimin e gjykimit në lidhje me fazën e dytë të pjesëtimit.

-Afatet janë tejkalluar në çështje kryesisht civile, me palë kundërshtare dhe disa paditësa ose të paditur dhe me kërkime komplekse (disa kërkime si pjesë e objektit të padisë), ku disa seanca gjyqësore janë shtyrë për njoftimin e palëve në mungesë të vendimeve të ndërmjetme të gjykatës të marrë në përgjigje të kërkesave të palëve psh shtim ndërgjyqësie, shtim të objektit të padisë, etj.

-Në disa çështje janë zhvilluar disa seanca përgatitore pasi jo gjithmonë institucionet janë përgjigjur në kohë për kërkesat e gjykatës për vënien në dispozicion të dokumentacionit që gjykata ka çmuar ta administroje kryesisht.

-Në disa çështje njoftimi i palës së paditur është bërë me shpallje publike, që në kërkësen për lëshimin e 'Deklaratës së Mbrojtjes', e në vijim për seance përgatitore dhe po me shpallje publike është komunikuar dhe urdhëri për caktimin e seancës gjyqësore. Shpallja afishohet për minimalisht 20 ditë sipas ligjit, por në caktimin e seancës pasardhëse është llogaritur dhe koha e nevojshme për dërgimin e saj për afishim nëpër njësitë administrative, nëse pala nuk ka qënë banor i qytetit të Korçës. Një njoftimi i pavlefshëm dhe për më tepër kur njoftimi është bërë me shpallje, passjell humbje kohe në përfundimin e gjykimit të çështjes. Njoftimet rezultojë të pavlefshme kryesisht për shkak të problematikave që shfaq shërbimi postar.

-Edhe në rastet e gjykimeve penale kryesisht mungesa e njoftimit efektiv të të pandehurit është bërë shkak për shtyrjen e seancës gjyqësore.

-Megjithëse kanë ardhur duke u minimizuar, ka patur dhe raste kur gjykimet janë shtyrë mbi kërkesën e mbrojtësve të palëve privatë ose të pandehurve me arsyetimin se ndodhen në gjykime të tjera, kërkesa të pranuar nga gjykata, megjithëse iu është tërhequr vëmendja mbrojtësve për këtë sjellje, për të mos iu mohuar palës e drejta për mbrojtje efektive”

Pretendimet e parashtruara nga ana e gjyqtarit në lidhje me përfundimin e disa prej çështjeve jashtë standardit minimal kohor analizohen në vijim në tërësinë e tyre duke vlerësuar se vetëm në disa prej tyre argumentet e gjyqtarit lidhur me analizën logjike të të dhënave dhe përjashtimin e rrethanave që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës, gjejnë mbështetje në Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve, pasi:

Së pari, standardet minimale kohore nuk janë afate të arsyeshme. Ato nxisin gjyqtarjan të jetë sa më produktiv, pavarësisht ngarkesës në punë. Standardet orientuese janë indikator matës i performancës së gjyqtarit. Ndërsa qëllimi i afateve të arsyeshme nuk është përcaktimi në mënyrë taksative i afateve të arsyeshme të gjykimit të çështjeve për gjyqtarjan në vetvete, por si afate maksimale për përfundimin e tyre, shkelja e të cilave legjitimon kërkuesin palë në proces që të kërkojë dëmshpërblim.

Së dyti, afatet e përcaktuara me vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së për përfundimin e çështjeve (civile apo penale) kanë qënë dhe ende janë afate orientuese në funksion të menaxhimit dhe efikasitetit të çështjeve gjyqësore nga ana e gjyqtarit. Këto afate orientuese shërbejnë si një standard matës për efekt të vlerësimit të gjyqtarëve, nëse ata në punën e tyre kanë ndërmarrë një rol të vëmendshëm në planifikimin e seancave gjyqësore dhe në sigurimin e administrimit efikas të seancave gjyqësore, e për rrjedhojë të përfundimit të çështjeve në një kohë sa më të shkurtër. Nga ana tjetër, tejkalimi i këtyre afateve orientuese, nuk nënkupton shkeljen e standardit të procesit të rregullt ligjor parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 të KEDNJ-së

Së treti, afatet e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale të detyrueshme për tu zbatuar (njoftimi i deklaratës së mbrojtjes, njoftimi me shpallje për palët...etj.), apo edhe ato optionale për tu zbatuar (shpallja e arsyetuar e vendimit, etj.) llogariten në afatin standard

orientues të gjykimit të çështjes. Standardet orientuese përfshijnë në vetvete edhe kohën që i duhet gjyqtarit për kryerjen e veprimeve procedurale, të tilla si: shtyrjen deri në 20 ditë për shpallje të arsyetuar të vendimit; shtyrjen deri në tre ditë për tu shprehur në lidhje me kërkesat e palëve ; respektimin e afatit 30/ditor për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes ; afatit 20/ditor për njoftimin e palëve me shpallje, afati 5/ditor për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim (neni 302/2 i K.Pr.Civile) etj.

Së katërti, afatet të cilat nuk janë në funksion të procesit (si p.sh. afati 35 ditë ne muajin Gusht - leja vjetore) apo afatet të cilat ecin për shkak të disa veprimeve procedurale (si p.sh. koha e kaluar nga pezullimi i çështjes deri në rifillimin e saj, koha e kaluar nga data e ankimit të një vendimi të ndërmjetëm, faza e parë e pjesëtimit, ankim ndaj pezullimit të çështjes, parashtrimi i konfliktit të kompetencës Gjykatës së Lartë, etj.), janë afate, të cilat nuk duhet të llogariten në afatin orientues, pasi ato nuk ecin jo për shkak të menaxhimit jo të mirë të çështjes nga ana e gjykatës. Në këtë kontekst, këto afate nuk duhet të llogariten në kohëzgjatjen e gjykimit, për aq sa rezultojnë të referuara nga ana e gjyqtarit për çështje konkrete apo nga të dhënat e pasqyruara në tabelat statistikore. Po kështu duhet mbajtur në vëmendje edhe caktimi i gjyqtarit si relatore e çështjes, në ato raste kur çështja është shortuar pas dhënies së dorëheqjes apo përjashtimit të gjyqtarëve të tjerë. Në rastin konkret nuk rezulton që gjyqtarja të ketë referuar të dhëna për kohën e pezullimit, kthimit të çështjes për vijimin e hetimeve, etj., për çështje konkrete, duke pamundësuar identifikimin dhe analizën e këtyre çështjeve. Për pasojë, në rastin konkret, duke iu referuar tabelave me të dhëna statistikore, e vetmja e dhënë objektive që rezulton është kohëzgjatja e gjykimit dikuar nga leja vjetore në muajin gusht, e cila do të analizohet dhe zbritet në çështjet respektive.

Në përlllogaritjen e standardit minimal kohor, për të gjitha dosjet, përlllogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtarit), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përlllogaritke do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune apo 5 javë kalenderike për gjyqtarët);
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve 6 ditë;

Gjyqtarja ka pretenduar që për disa çështje të mbahën parasysht shkaqet e tejkalimit. Duke mbajtur në konsideratë analizën e sipërcituar mbi pretendimet e parashtruara nga ana e gjyqtares, vlerësohet që të konsiderohen si çështje të cilat kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor çështjet si më poshtë:

- për vitin 2017 ;
 - (i) në tabelën nr. 1, çështja civile me palë kundërshtare me nr. rendor 12, është gjykuar për 188 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, rezulton që çështja të jetë gjykuar për 182 ditë. Tejkalimi i afatit me 2 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështja do të konsiderohen të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj (180 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së;**
 - (ii) në tabelën nr. 2, çështja civile pa palë kundërshtare me nr. rendor 7 është gjykuar për 62 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të

fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, rezulton që çështja të jetë gjykuar për 56 ditë, pra ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.*** Megjithatë edhe vetë tejkalimi i afatit me 2 ditë, pa zbritur festat e fundvitit, konsiderohte i papërfillshëm;

(iii) Në tabelën me nr. 10 (kërkesa penale të hetimit paraprake) çështjet me nr. rendor 20 dhe 21 janë gjykuar për 77 ditë dhe 64 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e lejes vjetore të muajit gusht, rezulton që çështjet të jenë gjykuar për 42 ditë dhe 29 ditë, ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së;***

(iv) Në tabelën me nr. 12, kërkesa penale e fazës së ekzekutimit me nr. rendor 57 është gjykuar për 61 ditë, duke e tejkaluar afatin 2 muaj me 1 ditë, tejkalimi i cili vlerësohet i papërfillshëm. Megjithatë, duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e lejes vjetore të muajit gusht, rezulton që çështja të jenë gjykuar për 26 ditë, pra ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***

- për vitin 2018 ;

(v) Në tabelën me nr. 9, çështjet penale kundravajtje me nr. rendor 8 dhe 22, janë gjykuar për 125 ditë dhe 130 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, rezulton që çështjet janë gjykuar për 90 ditë dhe 105 ditë, pra ***brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj (120 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së;***

(vi) Në tabelën nr. 11, çështjet penale seanca paraprake me nr. rendor 1, 127 dhe 130 janë gjykuar për 65 ditë, 71 ditë dhe 61 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve (nr.1) dhe kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, rezultojnë që çështjet janë gjykuar për për 59 ditë, 36 ditë dhe 26 ditë, pra ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së;***

(vii) Në tabelën me nr. 12, kërkesat penale të fazës së ekzekutimit me nr. rendor 59, 60, dhe 84 janë gjykuar për 65 ditë, 71 ditë dhe 74 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e disa çështjeve kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, rezulton se çështjet janë gjykuar për 30 ditë, 36 ditë dhe 39 ditë, pra ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***

- për vitin 2019 ;

(viii) në tabelën nr. 1, çështja civile me palë kundërshtare me nr. rendor 3, është gjykuar për 193 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, rezulton që çështja të jetë gjykuar për 158 ditë, pra ***brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj (180 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së;***

(ix) në tabelën nr. 2, çështja civile pa palë kundërshtare me nr. rendor 11 është gjykuar për 91 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, rezulton që çështja të jetë gjykuar për 56 ditë, pra ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së;***

(x) në tabelën nr. 4, çështjet familjare pa palë kundërshtare me nr. rendor 1 dhe 2, janë gjykuar për 63 ditë dhe 78 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e

çështjes lejen vjetore të muajit gusht (nr. 2) çështjet rezultojnë të gjykuara për 63 ditë dhe 43 ditë. Tejkalimi i afatit me 3 dite për njëren çështje do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD;***

(xi) Në tabelën me nr. 9, çështjet penale kundravajtje me nr. rendor 25 dhe 28, janë gjykuar për 150 ditë dhe 130 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes lejen vjetore të muajit gusht, rezulton që çështjet të jenë gjykuar për 115 ditë dhe 95 ditë, pra ***brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj (120 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së;***

(xii) Në tabelën nr. 11, çështja penale seanca paraprake me nr. rendor 1, 97, 106, 128, 131 dhe 148 janë gjykuar për 68 ditë, 65 ditë, 65 ditë, 77 ditë, 83 ditë dhe 65 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve (nr. 1) si dhe lejen vjetore të muajit gusht (nr. 128, 131), çështjet rezultojnë të gjykuara për 62 ditë, 65 ditë, 65 ditë, 42 ditë, 48 ditë dhe 65 ditë. Tejkalimi i afatit deri me 5 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm, për pasojë çështjet do të konsiderohen të gjykuara ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së;***

(xiii) Në tabelën me nr. 12, kërkesat penale të fazës së ekzekutimit me nr. rendor 74 dhe 86 janë gjykuar për 61 ditë dhe 66 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve (nr. 74), rezulton se çështjet janë gjykuar për 55 ditë dhe 66 ditë. Tejkalimi i afatit me 6 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm, për pasojë çështjet do të konsiderohen të gjykuara ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***

Pra, janë gjithsej 27 çështje që do të llogariten të gjykuara brenda standardit minimal kohor dhe do t'i zbriten numrit prej 72 çështjesh të përlllogaritura në raportin analitik, duke mbetur kështu 45 çështje.

Duke konsideruar sa më sipër, numri total i çështjeve për të cilat parashikohet standardi minimal kohor është 982 dhe numrit total të çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor rezulton të jetë 45 çështje, ose 4.58 % e numrit total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor. Kjo përqindje, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, përkon me nivelin e vlerësimit 5 (pesë) pikë (0-10% - 5 pikë).

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhë vlerësimi rezultoi se gjyqtarja ka përballuar një ngarkesë të lartë. Referuar të dhënave statistikore, rezultoi se në periudhën 3 vjeçare të vlerësimit gjyqtarja ka përfunduar ne total 1350 çështje, nga të cilat 828 çështje me palë kundërshtare (*civile, familjare, tregtare, marrëdhënie punë, penale krime, penale kundërvajtje, seanca paraprake*), e cila përbën rreth 61.3% të ngarkesën totale. Nga këto 95 çështje janë civile/familjare/tregate, ndërsa 733 janë penale. Referuar standardit sasior në fuqi¹⁴⁹, gjyqtarja duhet të përfundonte jo më pak se 100 çështje me palë kundërshtare në vit, pra 300 çështje në tre vjet, po të marrim në konsideratë faktin se gjyqtarja në shumicën e periudhës ka

¹⁴⁹ Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, të ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, shkronja a), parashikohet se “Gjyqtarja i gjykatës së shkallës së parë i dhomës penale, si relator, jo më pak se 100 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundravajtje)”.

qenë në seksionin penal, duke e tejkaluar standardin sasior me 144%. Ndërsa po të marrin si standard sasior 200 çështje në vit, rezulton se përsëri gjyqtarja e ka tejkaluar standardin sasior me 228 çështje.

Gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë kriter në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standadid minimal kohor, përjashtohen çështjet ku standardi është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (*deri në 7 ditë*), atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 45 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardid minmal kohor (45 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (982 çështje), rezulton të jetë 4.58 %. Për sa më sipër, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor prej 4.58 %, është brenda marzhi 0-10%.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është si më poshtë:

- i.* Në kategorinë e çështjeve “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 139 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- ii.* Në kategorinë e çështjeve “*Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 33 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- iii.* Në kategorinë e çështjeve “*Familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 96 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- iv.* Në kategorinë e çështjeve “*Familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 57 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;

- v. Në kategorinë e çështjeve “*Tregtare me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 154 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- vi. Në kategorinë e çështjeve “*Marrëdhënie pune*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 87 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- vii. Në kategorinë e çështjeve “*Penale-krime*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 42 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 9 apo 12 muaj;
- viii. Në kategorinë e çështjeve “*Penale-kundërvajtje*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 60 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- ix. Në kategorinë e çështjeve “*Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 39 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- x. Në kategorinë e çështjeve “*Seancë paraprake*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 31 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- xi. Në kategorinë e çështjeve “*Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 25 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin mbi mesatar ndërsa kryetari në nivel shumë të lartë.

Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër për të gjitha kategoritë.

KONKLUZIONI

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.¹⁵⁰ Referuar metodologjisë, duke qenë se për të gjitha kategoritë e çështjeve, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi minimal për të gjitha kategoritë e çështjeve, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë.

¹⁵⁰ Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se : “...Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarjat. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” vlerësohet se është më e shkurtër ose i barabartë me standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve e për këto arsye gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1350 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (1375 çështje) brenda periudhës 3/vjeçare të vlerësimit, **është 98.18 %** përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 8 pikë, duke qenë se rezulton në intervalin 93-99%.

Në vitin 2017 gjyqtarit i janë caktuar 330 çështje nga të cilat ka përfunduar 339 çështje, me një rendiment prej 102%.

Në vitin 2018 gjyqtarit i janë caktuar 514 çështje nga të cilat ka përfunduar 477 çështje, me një rendiment prej 92.8%.

Në vitin 2019 gjyqtarit i janë caktuar 531 çështje nga të cilat ka përfunduar 534 çështje, me një rendiment prej 100.5%.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin mbi mesatar ndërsa kryetari në nivel shumë të lartë. Gjyqtarja shprehet se “...Në 3 vite janë shortuar gjithësej 1375 çështje të reja, + 40 çështje të mbatura nga viti 2016, kam patur detyrimin e përfundimit të gjykimit për 1415 çështje, ndërkohë janë gjykuar 1350 çështje. Konstatohet se nga 1375 çështje të shortuara gjatë 3 viteve, 1350 janë përfunduar, duke u mbartur vetëm 25 çështje. Shkaqet e mospërfundimit të çështjes brenda vitit të rëna për gjykim, lidhen më shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore të pasqyruara më sipër, të pashmangshme pavarësisht nga vullneti dhe masat e marra për minimizimin e seancave jo produktive.

Ndërsa në çështjet civile me palë kundërshtare me ndryshimet e bëra në vitin 2017 në Kodin e Proçedurës Civile, merr më shumë kohë faza e veprimeve paraprake.

Mbahet në konsideratë se një pjesë e çështjeve kanë qënë të pezulluara për shkaqe ligjore”.

Referuar treguesit sasior, rezultoi se gjyqtarja ka përfunduar në periudhën 3 vjeçare të vlerësimit ne total 1350 çështje nga të cilat 828 çështje me palë kundërshtare (civile, familjare, tregtare, marrëdhënie punë, penale krime, penale kundërvajtje, seanca paraprake), rreth 61.3% e numrit total të çështjeve. Nga këto 95 çështje janë civile/familjare/tregate, ndërsa 733 janë penale. Referuar të dhënave statistikore rezulton se gjyqtarja në periudhë të shkurtra ka gjykuar në seksionin civil ndërsa pjesën më të madhë të periudhës së vlerësimit ka gjykuar në seksionin penal, duke qenë edhe gjyqtare e seksionin penal për të mitur. Ndërsa prej muajit mars 2019 ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve.

Lidhur me përcaktimin e aspektit sasior, në pikën 3, shkronja “a”, “e” dhe “g” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, të miratuar me vendimin nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD, përcaktohet se; *Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkesë pune minimale si më poshtë; a. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës penale, si relator, jo më pak se 100 gjykime çështjes penale (krime dhe kundravajtje penale); e. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit të përgjithshëm, jo më pak se 120 gjykime çështjes që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që nuk është organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 gjykime çështje, penale (krime dhe kundravajtje) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare”.*

Referuar standardit sasior në fuqi, gjyqtarja duhet të përfundonte jo më pak se 100 çështje me palë kundërshtare në vit në kohën kur ka gjykuar në seksionin penal dhe jo më shumë se 120 çështje me palë kundërshtare në vit për kohën kur ka gjykuar në seksionin civil, dhe në periudhën që ka gjykuar pa seksioni jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare në vit. Kështu po të marrim një mesatare të të gjithë këtyre periudhave, rezulton se gjyqtarja duhet të përfundonte jo më pak se 110 çështje me palë kundërshtare në dy vitet e para, 2017-2018 dhe jo më pak se 200 çështje për vitin 2019. Në rastin konkret rezultoi se gjyqtarja ka gjykuar 828 me palë kundërshtare, duke e tejkaluar standardin sasior me 408 çështje, apo me rreth se 97 %.

Në këto kushte gjyqtarja duhet të vlerësohet me pikëzim maksimal.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 98.18 %, pra thuhet 99%, përqindje që pikëzohet me 10 pikë, por ndërkohë rezulton se ajo ka tejkaluar standardin sasior për çështjet e themelit të përfunduara me 408 çështje në të gjithë periudhën e vlerësimit apo me 97 %, vlerësohet se, në analizë logjike të të dhënave statistikore, duke marrë në konsideratë përqindjen e çështjeve të shqyrtuar tej standardit afatit ligjor dhe standardit minimal sasior, e cila ka rezultuar nën 10 %, gjyqtarja duhet të vlerësohet dhe pikëzohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë, duke qenë se në çdo vit ajo e ka tejkaluar standartin minimal sasior, mbi 50 %, konkretisht me 97 %.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- i. Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsyetimit është 6 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- ii. Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsyetimit është 4 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- iii. Për çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsyetimit është 10 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- iv. Për çështje të kategorisë “*familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 14 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.
- v. Për çështje të kategorisë “*tregtare me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 2.5 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.
- vi. Për çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 7 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile
- vii. Për çështje të kategorisë “*krime*”, koha mesatare e arsyetimit është 6 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
- viii. Për çështje të kategorisë “*kundravajtje*”, koha mesatare e arsyetimit është 5 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
- ix. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:
 1. Për kërkesa me objekt vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi, 2.12 ditë, **pra më i shkurtër** se afati procedural i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K.Pr.Penale.
 2. Për kërkesa me objekt caktim mase sigurimi, koha mesatare e arsyetimit është 52.75 ditë, **pra më e gjatë** se afati procedural i parashikuar nga neni 244/1 i K.Pr.Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsyetuar¹⁵¹.
 3. Për kërkesa me objekt verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, 2.3 ditë, **pra më i gjatë** se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 248 i K.Pr.Penale.
 4. Për kërkesa me objekt zëvendësim mase sigurimi, 2.5 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 i K.Pr.Penale.
 5. Për kërkesa me objekt shuarje mase sigurimi, 2.25 ditë, **pra më i gjatë** se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 261/3 dhe 248/2 i K.Pr.Penal.
 6. Për kërkesa me objekt lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi, 238.6 ditë, **pra më i**

¹⁵¹ Kjo kategori çështjesh, ka të bëjë me çështje të sekretit hetimor, ku vendimi i dorëzohet i arsyetuar prokurorit, ndërsa në sekretarinë gjyqësore dorëzohet pasi të ketë humbur karakterin e saj si “*sekret*”. Të dhënat statistikore i referohet afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari.

gjatë se afati procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 i K.Pr.Penale¹⁵².

7. Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 4.5 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.

- x. Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:
 1. Për çështje me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, 6 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K. Pr. Penale.
 2. Për çështje për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 6.6 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

- xi. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:
 1. Për kërkesa me objekt përjashtimin e gjyqtarit (*pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të K.Pr.Penale me ligjin nr. 35/2017*), koha mesatare e arsyetimit është 3 ditë, **pra më e gjatë** se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 22 i K.Pr.Penale.
 2. Për kërkesa me objekt rivendosje në afat ankimi (*pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të K.Pr.Penale me ligjin nr. 35/2017*), koha mesatare e arsyetimit është 4 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 420 i K.Pr.Penale.
 3. Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 4 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.

Për sa më sipër, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë, përveç se për nënkategorinë ku bëjnë pjesë shqyrtimi i kërkesës për caktim mase dhe të kërkesës lejim përgjimi/zgjatje afat, të cilat janë kërkesa me natyrë sekrete, ku vendimi i jepet i arsyetuar prokorit, ndërsa dorëzimi në sekretari bëhet pasi kanë përfunduar hetimet. Për nënkategorinë “verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit”, “shuarje mase sigurimi” dhe “përjashtimin e gjyqtarit”, për të cilat ligji ka parashikuar afat të shkurtër arsyetimi, dy ditorë, gjyqtarja e ka tejkualuar përkatësisht me 0.2, 0.3 dhe 1 ditë, tejkalime këto që janë që konsiderohet e papërfillshme.

Sa më sipër, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, duke marrë në konsideratë tejkalimet e afatit të arsyetimit deri në 1 ditë tek tre nënkategoritë e mësipërme, si dhe faktin se tek kërkesat me natyrë sekrete, dorëzimi i dosjes në sekretari nuk tregon momentin e arsyetimit, faktin se gjyqtarja në të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë e tjera

¹⁵² Kjo kategori çështjesh, ka të bëjë me çështje të sekretit hetimor, ku vendimi i dorëzohet brenda 24 h prokurorit, ndërsa në sekretarinë gjyqësore dorëzohet pasi të ketë humbur karakterin e saj si “sekret”. Të dhënat statistikore i referohet afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari.

ka respektuar gjithmonë afatin e arsytimit të vendimit, vlerësohet se koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar, është më e shkurtër se afati procedural për të gjithë kategoritë e çështjeve, që sipas Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 15 pikë.

Megjithatë, edhe sikur të marrim të mirëqenë tejkallimet e mësipërme, të cilat siç e theksuam kanë qenë tepër të papërfillshme, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit është me e shkurtër se afati procedural është më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, që sipas Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 12 pikë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Në rastin konkret, lidhur me këtë tregues duke pasur në konsideratë, volumin e çështjeve ku rezultoi se për një periudhë tre vjeçare (2017-2019), gjyqtarja ka dhënë 1350 vendime, mesatarisht rreth 450 vendime në vit, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, konkretisht kohën angazhimit të gjyqtarës në gjykimet gjatë orarit zyrtar në ditët e javës, angazhimin e saj si anëtar i trupit gjykues, dhe faktin që tejkallimet në tre nënkategori janë vetëm disa orë apo maksimumi me 1 ditë, vlerësohet që për këtë tregues gjyqtarja të vlerësohet në një nivel më të lartë pikëzimi, që i korespondon pikëzimit maksimal prej 15 pikë. Gjithashtu, vlen të theksohet se për të gjitha kategoritë e çështjeve, koha mesatare e arsytimit të çështjeve është tepër e shkurtër në raport me afatin ligjor.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve” dhe gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë për këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategorivë e çështjeve.*

2.B AFTËSIA PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se të dhënat e evidentuara në tabelat statistikore nuk mund të përdoren pasi nuk përmbajnë të dhëna për numrin e seancave gjyqësore. Për pasojë, të dhënat për vlerësimin e këtij treguesi i referohen numrit të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim¹⁵³.

Referuar të dhënave të analizuara në Raportin analitik, rezultojnë se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përfshirë ato pa palë kundërshtare, rezultojnë si më poshtë:

- (i) për kategorinë e çështjeve "Penale themeli", është 4 (katër) seanca gjyqësore.
- (ii) për kategorinë e çështjeve/kërkesave "Seanca paraprake", "dërgim çështje në gjyq" dhe "pushim procedimi penal", është 2 (dy) seanca gjyqësore ;
- (iii) për kategorinë e çështjeve « civile themel » është 5 (pesë) seanca ;
- (iv) për kategorinë « familjare » është 2 (dy) seanca.

Në kategorinë "Penale themeli" në 4 çështje janë zhvilluar 16 seanca gjyqësore. Në kategorinë "Seanca paraprake", në 9 çështje me objekt "dërgim çështje në gjyq" dhe "pushim procedimi penal" janë zhvilluar 18 seanca gjyqësore, në kategorinë "civile themeli" në 1 çështje janë zhvilluar 5 seanca gjyqësore ndërsa në kategorinë "çështje familjare" janë zhvilluar 2 seanca për 1 çështje. Pra, në total për 15 gjykime janë zhvilluar 41 seanca gjyqësore.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare, rezultojnë të jetë **2.73 seanca gjyqësore**.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtarja ka kryer në mënyrë efektive veprimet për vënien në lëvizje të çështjes, ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me urdhër ose vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes, duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke urdhëruar kryerjen e njoftimeve për palët dhe marrjen e masave për të siguruar prezencën apo shoqërimin e të pandehurve.

¹⁵³ Sipas metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, në lidhje me këtë treguesin e numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, është parashikuar: "Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, **duke përfshirë ato pa palë ndërgjyqëse.**"

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: për t'i dhënë mundësi të pandehurve për t'u përfaqësuar nga avokatët e zgjedhur prej tyre; me qëllim përsëritjen e njoftimit viktimës së veprës penale; për t'i dhënë mundësi avokatit të të pandehurit për të përcaktuar provat që do të merren në shqyrtim; për njoftimin e dëshmitarëve; për thirrjen e ekspertit në gjykim; për t'i lënë kohë palës paditëse për t'u njohur me aktet e paraqitura nga i padituri; për t'i komunikuar palëve në mungesë ndryshimin e objektit të padisë; me kërkesë të përfaqësuesit të Avokaturës së Shtetit; për shkak të mungesës së prokurorit; për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim etj.

Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarit të çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

Caktimi i seancës së parë gjyqësore në ato raste kur parashikohet një detyrim ligjor për t'u respektuar (si afat maksimal), rezulton që gjyqtarja e ka respektuar afatin thuajse gjithmonë. Sipas raportit analitik, në çështjet e kategorisë seancë paraprake, referuar vendimit për kalimin e çështjes për shqyrtim, rezulton që gjyqtarja ka caktuar datën e seancës së parë gjyqësore brenda afatit ligjor 10 ditor të parashikuar në dispozitë neni 332/2 i K.Pr.Penale. Në ndonjë rast ky afat është tejkaluar për shkak të festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve¹⁵⁴. Përgjithësisht, rezulton se seancat gjyqësore janë shtyrë brenda një afati në maksimum prej 10 - 20 ditësh nga njëra – tjetra në çështjet civile/familjare dhe deri në 14 ditë, konform nenit 342/2 të K.Pr.Penale, në çështjet penale, por në disa raste konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës, për shkak të lejes vjetore në muajin gusht, apo në fund të vitit, periudhë që përkon me procedurën e mbartjeve të dosjeve nga administrata.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin mesatar ndërsa kryetari në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2.73 seanca dhe në çdo rast gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet maksimalisht, duke e pikëzuar me 15 pikë.

¹⁵⁴ Vendimi nr. 105/1029, datë 21.01.2019, vendimi nr.30/945 datë 07.01.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës është shumë e lartë dhe pikëzohet me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht, në çështjet civile gjyqtarja është shprehur me vendim, si për njoftimin e akteve dhe kërkesës padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, ashtu edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore ose pajtimi në çështjet familjare (*neni 158/b i K.Pr.Civile dhe neni 132 i K. Familjes*) e në vijim, pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe për nxjerrjen e urdhrit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (*neni 158/ç i K.Pr.Civile*). Në çështjet penale, konstatohet se gjithmonë gjyqtarja ka vënë dosjen në lëvizje brenda ditës në kërkesat penale ose brenda 5 ditëve, sikundër parashikohet në nenin 332/1 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, në nenin 329/b për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt pushimin e procedimit penal, në nenet 333/1 dhe 406/dh të K.Pr.Penale, për çështjet e kategorisë penale themeli.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja jo vetëm ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën, por ka treguar edhe kujdes maksimal në marrjen e masave për njoftimin e palëve, me qëllim zhvillimin e seancave efektive. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë, si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*), ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*) apo sipas ritit të gjykimit të zhvilluar (*nenet 405 e vijues të K.Pr.Penale në rastin e gjykimit të shkurtuar*), ose sipas ritit të gjykimeve të seancave paraprake (*neni 332/c i K.Pr.Penale*).

Gjatë gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relativitetin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit apo të të paditurve, shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për

marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me një vonesë më pak se 15 minuta, dhe vetëm në një rast me një vonesë prej 36 minuta¹⁵⁵ duke relatuar shkakun e fillimit të seancës me vonesë. Pavarësisht kësaj, nuk ka rezultuar në asnjë rast që vonesa të jetë bërë shkak për moszhvillimin e seancës gjyqësore. Në një rast¹⁵⁶, seanca është çelur më herët sesa ka qenë planifikuar, por çelja para kohe e seancës nuk ka sjellë asnjë pasojë, pasi i pandehuri, mbrojtësi dhe prokurori kanë qenë të pranishëm.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtarja ka parashtruar se: *“Në çështjet civile të shqyrtuara nga ana ime, kam marrë të gjitha masat për realizimin në kohë të detyrimeve procedurale për shqyrtimin pa vonesë të çështjes. Me shortimin e çështjes, kam studiuar dosjen, duke verifikuar nëse padia është e plotë dhe nëse ka qenë rasti, kam njoftuar palën paditëse për plotësimin e të metave brenda afatit ligjor. Me plotësimin e të metave kam vijuar me njoftimin e palës së paditur për paraqitjen e Deklaratës së Mbrojtjes, nëse është rasti, pasi jo në çdo çështje kërkohet një “Deklaratë mbrojtje”, psh nuk kërkohet një e tillë në çështjet me objekt zgjidhje martesë. Pasi është paraqitur Deklarata e Mbrojtjes, ajo i është njoftuar palës paditëse dhe janë pritur provat e reja që lidhen me prapësimet e parashtruara në Deklaratë, brenda 10 diteve nga marrja dijoni dhe keto të fundit, nëse janë paraqitur, i janë njoftuar pa vonesë të paditurit. Nëse ka qenë rasti kam caktuar seancë përgatitore për t'i dhënë përgjigje kërkimeve procedurale të palëve për të cilat gjykata duhet të shprehet me vendim ose nëse është cmuar e nevojshme kryerja e një ekspertimi. Pasi janë zhvilluar dhe seancat përgatitore, kam nxjerrë urdhërin për caktimin e seancës gjyqësore ku kam përcaktuar edhe provat që do të merren në shqyrtim, urdher i komunikuar palëve në mungesë. Për çdo kërkesë të palëve kam marrë vendim të ndërmjetëm dhe në rastet kur ligji parashikon ankim të vecantë kam kryer edhe arsyetimin me shkrim të vendimit. Për çdo seancë janë marrë masa për fillimin e gjykimit pa vonesë, por në disa raste sporadike seancat nuk kanë filluar në orarin e caktuar, kryesisht për shkak të mungesës së sallave të lira të gjykimit, të zëna nga një gjyqtar tjetër gjykimi i të cilit ka zgjatur tej afatit të planifikuar ose për shkak se pjesëmarrësit në gjykim kanë qenë në gjykime të tjera. Jo në pak raste ka ndodhur që i njëjti prokuror në një çështje penale ka patur dy gjykime të planifikuara në të njëjtën orë, situatë që nuk mund të shmanget pasi në momentin e planifikimit të çështjes për herë të parë nuk e*

¹⁵⁵ Vendimi nr. 183, datë 16.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

¹⁵⁶ Vendimi nr. 84, datë 29.01.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

njohim axhendën e prokurorit ose mbrojtësve. Në rast se prokurori ose mbrojtësi ka qënë ne gjykime të tjera, kam zgjedhur të pres dhe të filloj seancën me vonesë se të shtyj gjykimin... ”.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjyqimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në këtë kuptim përgjithësisht renditja ka filluar me aktet që kanë vënë në lëvizje gjykatën, aktet e paraqitura nga palët para fillimit të seancave, veprimet dhe vendimmarrjet e gjykatës gjatë veprimeve paraprake, nëse ka. Më pas kalohet tek procesverbalet, parashtrimet e palëve etj, gjithmonë sipas datës së zhvillimit të seancës. Në rastin konkret renditja sipas llojit të akteve procedurale por e ndërthurur kjo edhe me veprimet procedurale të kryera nga gjyqtarja gjatë gjyqimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të aksesueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtarja ka parashtruar se: *“Në dosjen gjyqësore aktet e paraqitura nga palët janë renditur sipas kohës së paraqitjes së tyre ndërsa urdhrat dhe vendimet e gjykatës janë renditur sipas kohës së kryerjes së tyre. Në këtë mënyrë dosja gjyqësore është lehtësisht e*

shfytëzueshme dhe e kuptueshme për çdo subjekt të interesuar, përfshi dhe gjykatat më të larta nëse çështja shqyrtohet prej tyre mbi bazë ankimi ose rekursi.”

KONKLUZIONI

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, është përfshirë vetëm dokumentacioni që i ka shërbyer zhvillimit të procesit gjyqësor konkret, duke filluar nga momenti i shortimit deri në dhënien e vendimit përfundimtar (*njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet për caktimin e seancave gjyqësore, vendimet e ndçermjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*kërkesa e prokurorit apo e të dënuarit, provat dhe diskutimet përfundimtare të palëve*).

Në dosjet penale rezulton të jetë administruar kopje e “Letres së të drejtave”, e cila i bashkëlidhet njoftimit për të pandehurin, personit nën hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale, me anë të cilës i janë njoftuar edhe të drejtat e parashikuara në nenin 34/a dhe nenin 58 të K.Pr.Penale, sipas parashikimeve në nenet 34/a¹⁵⁷, 58¹⁵⁸, 140¹⁵⁹ paragrafi 1 dhe 137¹⁶⁰ i

¹⁵⁷ Në nenin 34/a. pika 2 dhe 3 të K.Pr.Penale parashikohet se: “2. Përpara marrjes në pyetje për herë të parë ose përpara kryerjes së akteve ku prania e tij është e detyrueshme, sipas ligjit, organi procedues e njofton të pandehurin për të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar.

3. Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe.”.

¹⁵⁸ Neni 58 pika 2 i K.Pr.Penale parashikon se ; » 2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre. »

¹⁵⁹ Neni 140 paragrafi 1 parashikon se;”1. Njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij personalisht kopjen e aktit së bashku me letrën e të drejtave, sipas nenit 34/a, të këtij Kodi. Kur nuk mund t’i dorëzohet personalisht, njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vendin e punës, duke ia dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton me të ose një fqinji, ose një personi që punon me të. Në aktin e njoftimit tregohen gjenealitetet e personit që merr përsipër njoftimin dhe lidhja e tij me të pandehurin.”

¹⁶⁰ Neni 137 paragrafi i 1 parashikon se: “1. Njoftimet për personin e dëmtuar nga vepra penale bëhen njëjloj si për rastet kur njoftohet për herë të parë i pandehuri i lirë.”

K.Pr.Penale. Gjithashtu, në urdhërim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore është përcaktuar se njoftimit të të pandehurit/viktimës t'i bashkëngjitet letra e të drejtave (sipas rastit edhe akti procedural mbi të drejtat e viktimës së mitur në procesin penal¹⁶¹).

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtarja ka parashtruar se: “Në çdo dosje gjyqësore aktet janë të plota duke përfshirë çdo akt dhe kërkesë të paraqitur nga palët dhe të pranuar nga gjykata. Ato janë në formën e kërkuar nga ligji. Po kështu çdo dosje përmban të gjithë urdhërat me shkrim dhe vendimet e arsyetuara me shkrim të gjyqtarit. Në dosje janë paraqitur edhe të gjithë aktet që provojnë njoftimin e rregullt të palëve për çdo fazë të procesit. Nuk mund të imagjinohet që në një dosje të këtë dokumentacion që i përket një dosje tjetër.”.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve të që lidhen me çështjen konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A ETIKA NË PUNË

¹⁶¹ Vendimi nr. 293, datë 27.06.2018

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarës u konstatuan këto të dhëna:

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë¹⁶² rezultojnë se ndaj gjyqtarës Sonjela Voskopi në periudhën e vlerësimit 2017-2019 janë paraqitur 5 (pesë) ankesa të cilat janë arkivuar të gjitha dhe për asnjërën nuk është kërkuar t'i mbahet parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional.

Gjithashtu referuar kërkesës për informacion mbi vendimet përfundimtare për masa disiplinore të dhëna ndaj gjyqtarës Sonjela Voskopi rezultojnë se ndaj saj nuk është depozituar asnjë vendim i tillë, për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka sqaruar se nuk disponon informacionin e kërkuar.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë dhe thekson se *“Përsa i përket sjelljes gjatë ushtrimit të detyrës dhe etikës kam qënë sa më korrekte dhe dinjitoze, në çdo aspekt, që në veshje, në respektimin e orarit zyrtar, në njoftimin pranë Titullarit të shkaqeve objektive në rast mosparaqitje në punë, në marrëdhënie me kolegët, sekretaren gjyqësore, administratën e Gjykatës dhe për më tepër me palët. Nga ana ime është shmangur çdo sjellje e papërshtatshme ndaj palëve dhe kam orientuar palët në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre procedurale dhe persa i përket sjelljes në seancë...”*

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezultojnë asnjë sjellje që mund të çenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezultojnë se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e etikës së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B INTEGRITETI I GJYQTARIT

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

¹⁶² Shkresa 2268/1 Prot., datë 03.06.2021

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2017 - 31.12.2019, rezulton se për gjyqtaren Sonjela Voskopi janë depozituar 5 ankesa të cilat janë arkivuar pas verifikimit të tyre.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 2807/1 prot., datë 09.07.2021, rezulton se: a) *Deklaratat e interesave private periodike/vjetore 2017-2020 janë dorëzuar brenda afateve ligjore; b) Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit; c) Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave.*

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e integritetit të gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse

gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor, akteve të administruara në dosjet e gjyqimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit.

Gjyqtarja lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivelin shumë të lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2017–31.12.2019, janë paraqitur 8 kërkesa për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, nga të cilat 7 janë rrëzuar dhe vetëm 1 është pranuar. Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 14 kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 12 janë pranuar dhe 2 janë rrëzuar.

Gjyqtarja e ka vlerësuar numrin e kërkesave të pranuar për përjashtim si të pakonsiderueshëm. Gjyqtarja parashtron se: “...referuar numrit të çështjeve të gjykuara për secilin vit numri i kërkesave për përjashtim është i pakonsiderueshëm.”.

KONKLuzioni

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, janë pranuar vetëm 1 nga 8 kërkesat për përjashtimin e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, vlerësohet se ky numër është “I pakonsiderueshëm”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Gjatë zhvillimit të gjykimit, konstatohet se gjyqtarja përdor fjalë të thjeshta, të kuptueshme, të qarta dhe koncize me palët ndërgjyqëse dhe përfaqësuesit e tyre, duke e bërë procesin gjyqësor të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezultojnë se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk konstatohet që gjyqtarja të ketë ceduar në ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai është në dijeni për shkak të funksionit.

I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio.

Gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar aftësinë e saj në nivel të lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të larta në drejtim të këtij treguesi.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjithashtu rezulton se në ILD ankesat e depozituara ndaj gjyqtarit, janë arkivuar të gjitha. Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj ka qenë në nivelet më të larta, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore, por pa cënuar pavarësinë e njëri-tjetrit. Këtë qëndrim mban edhe kryetari i gjykatës.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna që negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se: “Shkalla e bashkëpunimit me administratën gjyqësore ka qenë në nivel maksimal, jo vetëm për krijimin e një ambjenti pune sa më harmonik, por dhe në zgjidhjen e problematikave të përditshme që dikton puna, psh me ftuesit gjyqësore në funksion të rritjes së përpjekjeve nga ana e tyre për njoftime të vlefshme për palët në një afat sa më të arsyeshëm, e me sekretaren gjyqësore në ndihmën e ofruar për kryerjen e detyrave funksionale nga ana e saj. Me asnjë person nga administrata gjyqësore dhe më gjerë me personelin e gjykatës nuk kam patur ndonjë konflikt.”

Edhe kryetari i gjykatës e ka vlerësuar maksimalisht këtë kriter.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T'U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja Sonjela Voskopi, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrëses, lehtësueses dhe ekspertes. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja Sonjela Voskopi është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) Në cilësinë e pjesëmarrësit në Programin e Formimit Vazhdues në 27 (njëzet e shtatë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit (nga data 5 prill 2017 deri në datë 18 dhjetor 2019), gjithsej 44 ditë trajnimi;
- (ii) Në cilësinë e lehtësueses në Programin e Formimit Vazhdues në 3 (tre) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit (nga data 7 mars 2018 deri në datë 2 korrik 2019), gjithsej 10 ditë trajnimi;
- (iii) Në cilësinë e ekspertes në Programin e Formimit Vazhdues në 1 (një) aktivitet trajnues të zhvilluar në gjithë periudhën e vlerësimit (data 19 dhjetor 2019), gjithsej 2.5 ditë trajnimi.

Gjyqtarja ka zhvilluar gjithsej 56.5 ditë trajnimi.

Gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke u shprehur se “*Kam marrë pjesë në shumicën e trajnimeve për të cilat pas kërkesës sime Shkolla e Magjistraturës ka dërguar ftesë dhe me pjesëmarrjen tim kam kapërcyer numrin e detyrueshëm prej 5 ditë trajnim të vendosur nga ligji. Pjesëmarrja ka qënë e kushtëzuar dhe nga ngarkesa në punë, apo në ditët e caktuara kur kam planifikuar trajnim kam rezultuar gjyqtare e gatshme për shqyrtimin e kërkesavë të palëve në fazën e hetimeve paraprake, ose padive me objekt lëshimin e urdherit të menjëhershëm të mbrojtjes, duke e bërë të pamundur pjesëmarrjen. Në trajnimet ku kam marrë pjesë kam qënë aktive në diskutime dhe kam shfaqur interes për çështjet në diskutim, duke ndarë me kolegët mendimin tim dhe praktiken time në lidhje me çështjet në diskutim”.*

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës penale, gjithsej 31 aktivitete të zhvilluara për 56,5 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është brenda kufijve 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses dhe ekspertes duke marrë pjesë si lehtësuese në 3 aktivitete dhe si eksperte në një aktivitet. Konkretisht:

1. Në aktivitetin e datës 7-8 mars 2018 me temë: “Gjykimi i çështjeve me elementë të huaj në fushën civile. Çështje të teorisë dhe praktikës gjyqësore”, në cilësinë e lehtësueses;
2. Në aktivitetin e datës 31 tetor 2018 me temë: “Përcaktimi i juridiksionit ndërkombëtar sipas Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe Kodit të Procedurës Civile me risitë e tij.” në cilësinë e lehtësueses;
3. Në aktivitetin e datës 19 dhjetor 2019 me temë: “Seanca paraprake dhe gjyqtari i seancës paraprake. Kontrolli i ligjshmërisë së hetimeve dhe roli garantues i tij.”, në cilësinë e ekspertes;
4. Në aktivitetin e datës 1-2 korrik 2019 me temë: “Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake. Probleme të kontrollit gjyqësor gjatë fazës së hetimeve paraprake.” në cilësinë e lehtësueses.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për ketë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren Sonjela Voskopi duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësueses dhe ekspertes në aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtarja Sonjela Voskopi ka deklaruar se: “Nuk kam udhëhequr kandidatë për gjyqtarë për shkak së stazhi profesional nga kandidatët për gjyqtarë bëhet pranë Gjykatave të Shkollës së Parë Tiranë. Kam marrë pjesë si lehtësuese dhe eksperte pranë Shkollës së Magjistraturës në disa tema.

-Si lehtësuese në trajnimin me temë: “Gjykimi i çështjeve me elementë të huaj në fushën civile. Çështje të teorisë dhe praktikës gjyqësore”, të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në datat 7-8 mars 2018.

-Si lehtësuese në trajnimin me temë : Përcaktimi i juridiksionit ndërkombëtar sipas Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare private dhe Kodit të Procedurës Civile me risitë e tij”, “, të

organizuar në 31 tetor 2018, ku kam bërë dhe një prezantim, me temë: “Juridiksioni i Gjykatave Shqiptare në Cështje me Element të Huaj”

-Si eksperte në trajnimin me temë: ‘Seanca paraprake dhe gjyqtari i seancës paraprake. Kontrolli i ligjshmërisë së hetimeve dhe roli garantues i tij’ të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në datën 19 dhjetor 2019, ku kam prezantuar materialin me temë: ‘Roli kontrollues i gjyqtarit te seancës paraprake në shqyrtimin e një kërkesë të prokurorisë me objekt dërgimin e çështjes në gjyq’.

-Si lehtësuese në trajnimin më temë: “Roli i prokurorit ne drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake. Probleme te kontrollit gjyqësor gjatë fazës së hetimeve paraprake”, të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në datat 1-2 korrik 2019.”

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja është angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësuese dhe eksperte pranë Shkollës së Magjistraturës.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” rezulton angazhimi i gjyqtares si lehtësuese dhe eksperte dhe për pasojë gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton se ka të dhëna për këtë tregues.

Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtarja Sonjela Voskopi ka deklaruar se: “Kam marrë pjesë në një tryeze bashkëpunimi me grupe të interesit të organizuar nga ‘Observatori për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve’, në datë 10.03.2017, ku kam bërë një prezantim më temë ‘Roli i gjykatës në lejimin e martesavë nën moshë “për shkaqe me rëndësi”.

-Kam marrë pjesë në një tryezë bashkëpunimi më komunitetin të organizuar në Korçë në datë 26.11.2019 ku kam paraqitur një prezantim me temë: “Kodi i Drejtësisë Penalë për të Mitur, risitë dhe sfidat në implementimin e tij, në kuadër të parimit bazë kushtetues, interesit më të lartë të të miturit.

- Në vitin 2019 kam marrë pjesë si eksperte në një tryezë të rrumbullakët të organizuar nga shoqata "Unë Gruaja", me seli në Pogradec, me temë: "Duajini fëmijët dhe në vend të ndëshkimit zgjidhni edukimin dhe ndërmjetësimin".

Lidhur me këtë tregues në Metodolinë e Pikëzimit parashikohet se; "Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike".

Më datë 13.09.2024 pranë KLGJ-së me nr. 4337 prot, datë 13.04.2024 është depozituar dokumentacioni në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional, bashkëngjitur të cilit është paraqitur vërtetimi me nr. 355 prot., datë 03.09.2024, lëshuar nga qendra "Observatori për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjëve", ku citohet se Z, Sonjela Voskopi, në rolin e gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ka qenë lektore më takimin prezantues të raportit mbi martesat nën moshë, më datë 10 mars 2017. Kjo nismë është realizuar në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, me mbështetjen e qeverisë Kanadeze dhe nën vëmendjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale (në atë kohë).

Gjithashtu, nga gjyqtarja është depozituar edhe vërtetimi datë 11.09.2024, lëshuar nga Shoqata "Unë Gruaja" Pogradec, me anë të cilës vërtetohet se Znj. Sonjela Voskopi është kontraktuar si eksperte e jashtme/ trajnere për periudhën 01.11.2019- 30.11.2019 nga shoqata "Unë gruaja", me nr.nipti K73919602N, në kuadër të projektit "Duajini Fëmijët; Në vend të ndëshkimit zgjidhni edukimin dhe ndërmjetësimin", i cili u zbatua në kunoër të programit "Shoqëria Civile në veprim për ndërtimin e qasjes dhe praktikave restorative për fëmijët dhe të rinjtë në konflikt ose në kontakt me ligjin", i financuar nga Bashkimi Evropian.

Bazuar në sa parashikohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren Sonjela Voskopo, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në veprimtari me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, në bashkëpunim me shoqata të ndryshme.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja është angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera, konkretisht në veprimtari me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë, pasi rezulton angazhimi i saj në këto veprimtari.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë publikuar punime akademike.

- Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtarja Sonjela Voskopi ka deklaruar “Nuk kam publikime të kësaj natyre.”

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

F- NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Nivelin i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	395	Shkëlqyeshëm

REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuarra dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja Sonjela Voskopi të vazhdojë të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN SONJELA VOSKOPI
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2019

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT				Pikët total	Niveli i vlerësimit	
				100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë		
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:	

		2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	0-10%	15	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 3 pikë

ngarkesën në punë		3. Mendimi përfundimtar i kryetarit			31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e

					çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99 %	10	Tej standardit : Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin

					procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë

					Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë

		ILDKPKI			
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				95	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	

A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë

					Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			395		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			Shkëlqyeshëm		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR